

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

raportet e akreditimit, bibliotekat dhe revistat



botues

ADMOVERE

drejtësi transicionale | edukim | paqëndërtim

<http://admovere.org/>

për botuesin

Shkëlzen Gashi

hulumtues

Aulonë Memeti

Ardianë Shala

ky raport u hartua nga

Shkëlzen Gashi

Aulonë Memeti

recensentë

Arbër Vokri

Imer Topanica

Valmir Krasniqi

Xhevahir Kolgjini

fotografia në kopertinë

Gazmend Bajri

dizajni i kopertinës dhe faqesja:

Bubrrëcat

shtypi

Printingpress

dhjetor 2018

Prishtinë

tirazhi

300

hulumtimi dhe botimi u përkrahën nga

KFOS (Kosovo Foundation for Open Society)



ADMOVERE është anëtare e Koalicionit për Integritet dhe Transparencë në Universitet – KITU, mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS. Ky hulumtim është pjesë e programit të KITU-së. Pikëpamjet e shprehura në këtë hulumtim janë të OJQ-së ADMOVERE dhe nuk paraqesin medoemos pikëpamjet e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur – KFOS, e as të recensentëve.

ADMOVERE (Transitional Justice | Education | Peacebuilding) angazhohet për ndërtimin e një shoqërie demokratike, promovimin e tolerancës e bashkëjetesës dhe luftimin e paragjyqimeve; dialogun mes komuniteteve të ndara për t'i tejkaluar mosmarrëveshjet, si dhe promovimin e praktikave të mira për drejtësi dhe pajtim. Fushat kryesore të organizatës janë të drejtat e njeriut, me theks të veçantë te drejtësia transicionale, edukimi dhe ndërtimi i paqes. Për më shumë: <http://admovere.org/>

PËRMBAJTJA

SHKURTESAT	4
HYRJE	6
I. RAPORTET E AKREDITIMIT DHE PROGRESI	10
II. BIBLIOTEKAT DHE SALLAT	44
III. REVISTAT AKADEMIKE	60
PËRFUNDIMET	76

SHKURTESAT

ADA	Austrian Development Agency
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
ALED	The Aligning Education with Labour Market Needs
BA	Bachelor
BE	Bashkimi European
CEEOL	Central Eastern European Online Learning
DA	Departamenti i Arkitekturës
EBSCO	Elton B. Stephens Co
ECTS	European Credit Transfer System
ERASMUS	European Region Action Scheme for the Mobility of University Students.
FIEK	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
FIM	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
FNA	Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës
FShMN	Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore
ISBN	International Standard Book Number

ISSN	International Standard Serial Number
JICA	Japan International Cooperation Agency
KFOS	Kosovo Foundation for Open Society
KITU	Koalicioni për Integritet dhe Transparencë në Universitet
MA	Master of Arts
MAShT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PhD	Doctor of Philosophy
TEMPUS	Trans-European Mobility Programme for University Studies
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	United States Agency for International Development
SOL	Student Open Learning

HYRJE

Qëllimi i parë i këtij hulumtimi është të prezentohen rekomandimet e raporteve finale të Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA) për drejtimit më të kërkuara në secilin fakultet të UP-së. Për këtë: a) u konsultuam me dekanët se cilat janë drejtimit më të kërkuara në fakultetet që ata drejtojnë; b) analizuam raportet finale të AKA-së për këto drejtime; dhe c) zhvilluam intervista me dekanët / prodekanët e fakulteteve, e ndonjëherë edhe me shefat e departamenteve, për të parë se sa progres është arritë në përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë dhe implementimin e rekomandimeve të ekspertëve të AKA-së, që nga akreditimi i fundit. Prej 13 dekanëve, 10 pranuan të intervistoheshin e tre refuzuan: But Dedaj i Ekonomisë, Haxhi Gashi i Juridikut dhe Lindita Sejdiu-Rugova e Filologjisë. Një kufizim i kësaj pjese të hulumtimit është se jo çdo herë raportet finale të AKA-së ishin relevante për drejtimit e rekomanduara nga menaxhmentet e fakulteteve.

Qëllimi i dytë i këtij publikimi është evidentimi i gjendjes në biblioteka dhe salla të leximit të fakulteteve të UP-së: a) ka secili fakultet bibliotekë dhe sallë të leximit; sa janë të furnizuara bibliotekat; si bëhet regjistrimi i librave; si është gjendja në sallat e leximit; sa ekzemplarë ka në bibliotekën e secilit fakultet; sa është numri i ulëseve në salla të leximit; sa është raporti ulëse-studentë, e me radhë. Për këtë: a) zhvilluam intervista me bibliotekistet e fakulteteve; b) vizituam bibliotekat dhe sallat e leximit për të parë gjendjen në to; dhe c) analizuam raportet e fundit të AKA-së për secilin fakultet. Ndër kufizimet kryesore të këtij hulumtimi ishin: a) mungesa e bibliotekistëve në disa fakultete për shkak të pensionimit të tyre (për këtë kemi kontaktuar zyrtarë të tjerë nëpër këto fakultete); b) pamundësia për të pasë qasje në disa prej bibliotekave; dhe c) mungesa e raporteve të AKA-së për disa prej fakulteteve.

Qëllimi i tretë dhe i fundit i këtij publikimi ishte për të parë se a kanë 13 fakultetet e UP-së (me 41 departamente gjithsej) revista ku publikohen punimet eventuale të stafit? Nëse nuk kanë, pse nuk kanë? Nëse kanë, a janë të qasshme për gjithë komunitetin në çdo kohë, a kanë ISSN, a kanë 'peer review' dhe a janë të indeksuara në databaza serioze? Të gjitha këto kriterë shërbejnë për t'u siguruar se revista i përmbushë standardet teknike dhe cilësore të një reviste serioze.

I. RAPORTET E AKREDITIMIT DHE PROGRESI

I. RAPORTET E AKREDITIMIT DHE PROGRESI

Hyrje

Qëllimi i parë i këtij hulumtimi është të prezentohen rekomandimet e raporteve finale të Agjencisë Kosovare të Akreditimit (AKA) për drejtimit më të kërkuara në nivelin Bachelor në secilin fakultet të UP-së. Për këtë: a) u konsultuam me dekanët se cilat janë drejtimit më të kërkuara në fakultetet që ata drejtojnë; b) analizuam raportet finale të AKA-së për këto drejtime; dhe c) zhvilluam intervista me dekanët / prodekanët e fakulteteve, e ndonjëherë edhe me shefat e departamenteve, për të parë se sa progres është arritë në përmirësimin e përgjithshëm të cilësisë dhe implementimin e rekomandimeve të ekspertëve të AKA-së, që nga akreditimi i fundit. Prej 13 dekanëve, 10 pranuan të intervistoheshin e tre refuzuan: But Dedaj i Ekonomisë, Haxhi Gashi i Juridikut dhe Lindita Sejdiu-Rugova e Filologjisë. Një kufizim i kësaj pjese të hulumtimit është se jo çdo herë raportet finale të AKA-së ishin relevante për drejtimit e rekomanduara nga menaxhmentet e fakulteteve.

1. Fakulteti i Arteve dega e arteve figurative

Raporti final i AKA-së, i përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në qershor 2016, fillon me vërejtje të përgjithshme për fakultetin, të cilat lidhen edhe me degën e arteve figurative¹. Fillimisht raporti vë në pah dy çështje të rëndësishme: komunikimin dhe matjet e suksesit. Sa i takon komunikimit, raporti sugjeron që të përmirësohet komunikimi në mes të vet stafit akademik, e edhe mes stafit dhe menaxhmentit. Lidhur me këtë, ekspertët kanë vënë re se gjatë diskutimeve punuese në procesin e akreditimit, vetëm dy nga më shumë se dhjetë pjesëtarë kanë marrë pjesë në diskutim, duke dhënë komente e sugjerime. Sipas ekspertëve, pjesëtarët e stafit që ishin në takim nuk e kishin sensin e përgjegjësisë, hezitonin dhe nuk ndiheshin pjesë e zhvillimeve. Te çështja e dytë, matjet e suksesit, theksohet nevoja për të pasur parasysh faktorët e shumtë që shërbejnë si matës suksesi. Shembull: artistët e shumtë që ka prodhuar fakulteti janë një nga indikatorët e suksesit, por nuk duhet harruar edhe faktorë tjerë, si notat e studentëve, shkëmbimet e ndryshme, përfshirjen e të diplomuarve në tregun e punës, e me radhë.

Sa i takon kurrikulës së programit, raporti thekson se përshkrimet e programeve duken shumë të përgjithësuara, e kjo krijon konfuzitet te studentët duke ua pamundësuar të krijojnë një ide të qartë se si do të zhvillohet lënda dhe mësimi gjatë gjithë semestrit. Po ashtu, përsëritja e materialeve të njëjta është shqetësuse, andaj ekspertët rekomandojnë fokusim më të madh në specifikat e lëndëve dhe evitim të përsëritjes së materialeve. Në linjë me këtë, duke qenë se shumica e programeve janë të bazuara në punë praktike/studioje, atëherë edhe raporti teori-praktikë do të duhej të ishte në përputhje me këtë. Mirëpo, sipas ekspertëve, është e kundërta: për shumicën e lëndëve 60% e kursit është teori e 40% praktikë.

AKA:

“Gjatë diskutimeve punuese për akreditim, vetëm dy nga më shumë se dhjetë profesorë kanë marrë pjesë në diskutim, duke dhënë komente e sugjerime. Pjesëtarët e stafit që ishin në takim nuk e kishin sensin e përgjegjësisë, hezitonin dhe nuk ndiheshin pjesë e zhvillimeve.

¹ Brayshaw, T., et al. «External Report: June 2016», faqe 12-21, Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2016.

Dekani Agim Selimi:

“**Observimi i ekspertëve është tregues i qartë se çfarë ambienti i punës është trashëguar nga mandati i kaluar. Stafi merr pjesë kohë pas kohe në një program për edukim/mësimdhënie, që organizohet në nivel universiteti, e kjo ndoshta do të ndikoj në përmirësim të komunikimit.**

Sa i përket përmirësimit të eksperiencës së studentëve në fakultet, ekspertët rekomandojnë që të krijohet një ambient më i mirë teknologjik, ku do të mund të zhvillohej SOL (Supported Open Learning), hapësira elektronike që t’u mundësonte studentëve dhe stafit të ngarkojnë detyrat, raportet, përmbledhjet, videot, etj., në mënyrë që të mund të shkëmbejnë komente e sugjerime dhe të zhvillojnë debat. Një tjetër rekomandim është pajisja me teknologji të pastër për drejtimin e dizajnit grafik, pajisja e disa klasëve me PC ose MAC, me programe e softuere për studentët e dizajnit grafik.

Dy vite pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritur brenda kësaj kohe, intervistua dekanin Agim Selimi. Sa i takon komunikimit, ai thotë se observimi i ekspertëve është tregues i qartë se çfarë ambienti i punës është trashëguar nga mandati i kaluar dhe shton se stafi merr pjesë kohë pas kohe në një program për edukim/mësimdhënie, që organizohet në nivel universiteti, e kjo ndoshta do të ndikoj në përmirësim të komunikimit. Lidhur me matjet e suksesit, dekanin tregon se suksesin e masin përmes këtyre indikatorëve: pjesëmarrja në tregun e punës, numri i të diplomuarëve, prezentimet e ndryshme kombëtare e ndërkombëtare dhe çmimet e ndryshme që marrin krijuesit.

Rreth kurrikulës dhe përsëritjes së materialeve, Selimi thotë se janë krijuar grupe punuese, të cilat do të fokusohen kryesisht në specifika të veçanta dhe shton se arsyeja e përsëritjeve të materialeve të njëjta ndodhë për shkak se Fakulteti i Arteve ka shumë lëndë zgjedhore, të cilat pastaj bëhet e vështirë për t’i menaxhuar, meqë kjo krijon staf të panevojshëm. Për ndarjen e punës teorike e praktike, dekanin thotë se ato i kanë të ndara në mënyrë të barabartë, dhe shton se studentët vlerësohen për produktin e tyre final. Për SOL-in dhe teknologjinë e pastër, ai thotë se fakulteti nuk është ende në atë stad që të aplikojë metoda të tilla në mënyrë të organizuar, kurse për rekomandimin që programi i dizajnit grafik të pajiset me PC/

MAC, tregon se tashmë është studioja e pajisur me PC dhe softuerët përkatës².

2. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë ekonomia e bujqësisë

Raporti final i AKA-së, i përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në maj 2016, paraqet një sërë rekomandimesh për drejtimin ‘Ekonomia e Bujqësisë’, ndonëse programi në fjalë u rekomandua në raportin paraprak të akreditimit pa ndonjë vërejtje të madhe.³ Sidoqoftë, sa i takon programit akademik dhe menaxhimit të studentëve, ekspertët vlerësojnë se programi ‘Ekonomia e Bujqësisë’ qëndron përgjithësisht mirë, por rekomandojnë ndryshime për konceptin gjithëpërfshirës didaktik, ngjashmëritë e përm-bajtjeve akademike të kurikulave dhe kriteret pranuese.

Problematika e parë sipas raportit është se ky program aftëson studentët për hulumtime kuantitative e kualitative dhe se mësimi bazohet në metoda të ndryshme didaktike si: ligjërata, seminare, ushtrime, ekskurziona...; mirëpo, mungon një platformë universitare gjithëpërfshirëse. Problematika e dytë është nevoja për të ndarë dhe rregulluar pjesë të kurrikulës në rastet kur ka ngjashmëri të madhe. Problematika e tretë janë kriteret pranuese, ndonëse procedurat për pranimin e studentëve të rinjë janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, numri i atyre që lënë studimet vazhdon të jetë i lartë, andaj duhet të aplikohen kriteret më strikte.

Ekspertët vlerësojnë se për stafin nuk ka kërkesa të përcaktuara qartë për aftësitë e tyre didaktike, por megjithatë rekomandojnë që Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë të mendojë për metodat që do t'i vlerësonin dhe t'i

AKA:

“ Ndonëse procedurat për pranimin e studentëve të rinjë janë në përputhje me standardet ndërkombëtare, numri i atyre që lënë studimet vazhdon të jetë i lartë, andaj duhet të aplikohen kriteret më strikte.

² Intervistë me Agim Selimin, Dekan i Fakultetit të Arteve, 16 tetor 2018.

³ Kantelhardt, Jochen dhe Doluschitz, Reiner. «Readreditation Procedure», faqe 11-19, Agjencia Kosovare e Akreditimit, maj 2016.

përmirësonin edhe më tej aftësitë didaktike të stafit. Sa i takon menaxhimin të cilësisë, raporti sqaron se ka shumë për t'u bërë, ndonëse më 2015 është themeluar një bord këshillues, i cili kontribuon në sigurimin e cilësisë dhe është krijuar një formë online e vlerësimit të profesorëve nga studentët, por, sipas ekspertëve, problemi është se nuk ka procedurë për njoftimin e rezultateve të vlerësimeve, prandaj rekomandojnë që ajo të krijohet patjetër.

Dy vite pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritë brenda kësaj kohe, intervistua dekanin Skënder Kaçi. Sa i takon mungesës së platformës gjithëpërfshirëse, Kaçi thotë se ka llojllojshmëri të metodave që përdoren gjatë procesit të mësimdhënies, mirëpo nuk ekziston një platformë e rregulluar në nivel të fakultetit e as të universitetit. Për çështjen e dytë – rregullimi i pjesëve të kurrikulës ku ka ngjashmëri, Kaçi thotë se këtë e kanë identifikuar dhe diskutuar, por profesorë të ndryshëm ligjërojnë lëndë të njëjtë, e kjo nuk mund të ndryshohet deri në riakreditim, meqë kështu janë procedurat. Për çështjen e tretë, Kaçi pohon se kriteret pranuese janë të përcaktuara në nivel qendror dhe e pranon se ka anomali në raport me numrin e studentëve që regjistrohen dhe atyre që i lënë studimet - mesatarisht 100 studentë në vit i tërheqin dokumentet e tyre pasiqë të regjistrohen.

Për vlerësimin dhe përmirësimin e aftësive didaktike të stafit akademik të këtij fakulteti, Kaçi vlerëson se ekspertët e jashtëm nuk e kuptojnë gjithëherë situatën këtu, e për rrjedhojë, japin edhe rekomandime që nuk janë në përputhje me rrethanat dhe mentalitetin. Rreth vlerësimeve të stafit akademik nga studentët dhe pse profesorët nuk i marrin këto rezultate, dekanin thotë se as ai vetë nuk i merr ato⁴.

Dekani Skënder Kaçi:

“Kriteret pranuese janë të përcaktuara në nivel qendror. E pranoj se ka anomali në raport me numrin e studentëve që regjistrohen dhe atyre që i lënë studimet - mesatarisht 100 studentë në vit i tërheqin dokumentet e tyre pasiqë të regjistrohen.

⁴ Intervistë me Skënder Kaçin, Dekan i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, 18 tetor 2018.

3. Fakulteti i Edukimit programi fillor

Sipas raportit final të AKA-së, i përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në maj të vitit 2016, Fakulteti i Edukimit, por edhe programi fillor, kanë pasur ndryshime pozitive në vazhdimësi. Sa i takon kurrikulës dhe mësimdhënies, ekspertët vlerësojnë se programi fillor qëndron mirë në të gjitha pikat, por rekomandojnë që të punohet më shumë në mbështetjen e mësimit të pavarur, të furnizohet biblioteka, e cila është shumë e varfër, dhe të shqyrtohet përfshirja ose jo e diplomës në fund të studimeve. Për hulumtimin dhe ndërkombëtarizimin, ekspertët vlerësojnë se ka ende shumë për t'u bërë dhe se duhen gjetur mënyra për të zhvilluar performancën e hulumtimeve të stafit akademik. Po ashtu, ata theksojnë se përveç projektit të TEMPUS-it dhe të USAID-it, prej të cilave ka përfutuar stafi, duhet të punohet më shumë në shkëmbime ndërkombëtare. Sa i takon stafit, ekspertët vlerësojnë se gjendja është e kënaqshme⁵.

Dy vite pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritë brenda kësaj kohe, intervistua prodekanen Majlinda Gjelij. Lidhur me metodat e mësimdhënies dhe mbështetjes së mësimit të pavarur, ajo thotë se përveç ligjëratave, organizohen edhe projekte, prezentime, punë grupore, punë praktike e seminare. Për gjendjen e bibliotekës, që është një nga shqetësimet e raportit të AKA-së, prodekanja thotë se stafi shfrytëzon më shumë literaturë në anglisht, “e ajo çka na nevojitet është të përkthehen tekste të caktuara universitare në shqip”. Rreth temës së diplomës, Gjelij sqaron se kanë pasë temë të diplomës çdo vit, por që nga akreditimi i fundit fakulteti ka bërë kërkesë që në vend të temës së diplomës, programi të përfundojë me një test përmbledhës, ku përfshihen lëndët e të gjitha viteve. Ekspertë e akreditimit kanë

AKA:

“ Të punohet më shumë në mbështetjen e mësimit të pavarur, të furnizohet biblioteka, e cila është shumë e varfër, dhe të shqyrtohet përfshirja ose jo e diplomës në fund të studimeve.

⁵ Bratengeyer, Erwin, et al. «External Evaluation Report», faqe 18-20, Agjencia Kosovare e Akreditimit, maj 2016.

Prodekanja Majlinda Gjellaj:

“Lidhur me metodat e mësimdhënies dhe mbështetjes së mësim-it të pavarur, përveç ligjëratave, organizohen edhe projekte, prezentime, punë grupore, punë praktike e seminare. Për gjendjen e bibliotekës stafi shfrytëzon më shumë literaturë në anglisht, e ajo çka na nevojitet është të përkthehen tekste të caktuara universitare në shqip.

kthyer vërejtje, por s’e kanë refuzuar kërkesën, andaj nga viti 2020 do të aplikohet kjo metodë.

Për çështjen e dytë, hulumtimi dhe ndërkombëtarizimi, Gjellaj tregon se në hulumtime nuk ka bashkëpunime në mes të stafit dhe studentëve sepse studentët e nivelit BA nuk angazhohen nga profesorët. Sipas saj, Fakulteti i Edukimit ka bashkëpunime ndërkombëtare - përmes ERASMUS + dhe MEVLANA - që janë shkëmbime të studentëve dhe të stafit. Gjellaj tregon se kanë partneritet me Universitetin e Indianës dhe atë të Lublanës në Europë – përmes tabelave të mençura, stafi mund të ndjekë ligjërata nga Unversiteti i Indianës, e së shpejti pritet që edhe ligjëratat e doktoraturës të zhvillohen me Univesitetin e Lublanës⁶.

4. Fakulteti i Ekonomisë banka, financa dhe kontabilitet

Raporti final i AKA-së, i përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në korrik 2015, paraqet një serë rekomandimesh për drejtimin ‘Banka, Financa dhe Kontabilitet’⁷. Sa i takon programit akademik dhe menaxhimit të studentëve, ekspertët vlerësojnë se programi ‘banka financa dhe kontabilitet’, lë ende shumë për të dëshiruar.

Çështja e parë është pse Fakulteti i Ekonomisë ka një program të titulluar ‘Banka, Financa dhe Kontabilitet’ dhe një tjetër vetëm ‘Kontabilitet’, kur, sipas ekspertëve shumica e lëndëve që ofrohen në këto dy programe janë të njëjta, e edhe kur emrat e lëndëve ndryshojnë, përmbajtja e tyre është e njëjtë. Për rrjedhojë, raporti rekomandon që programi ‘Banka, Financa dhe Kontabilitet’ t’i përjashtojë disa lëndë specifike të lëmisë së kontabilitetit

⁶ Intervistë me Majlinda Gjellajn, Proekane e Fakultetit të Edukimit, 3 tetor 2018.

⁷ Tönninsson, Kristina, et al. «Final Report», faqe 18-22, Agjencia Kosovare e Akreditimit, korrik 2015.

e të përfshijë lëndë specifike të fushës. Gjithashtu, raporti rekomandon që të rishikohet kurrikula e programit të kontabilitetit me qëllim që të pasqyrohet më shumë specializimi në lëminë e kontabilitetit.

Çështja e dytë është dallimi në mes të literaturës obligative dhe asaj të rekomanduar. Disa lëndë në BA kanë nga 4-5 libra, mirëpo të njëjtat libra ndodhë që të figurojnë edhe për nivelin MA. Raporti vlerëson se ndarja dhe kalkulimi i kredive për lëndë nuk janë të qarta dhe rekomandon që disa kredi të ndahen edhe për internship.

Çështje tjetër tejet e rëndësishme është përpjesa staf-studentë. Në këtë pikë 'Programi Banka, Financa dhe Kontabilitet' qëndron më së keqi. Vetëm në vitin akademik 2014/15 kuota për pranimin e studentëve ishte 400, e ishin pranuar 713 studentë. Sipas ekspertëve, kjo e afekton cilësinë e programit, sidomos kur dihet se profesorët kanë të drejtë të punojnë edhe në institucione tjera arsimore (publike e private), andaj ata rekomandojnë që patjetër të rregullohet përpjesa staf-studentë.

Sa i përket hulumtimit dhe bashëpunimit ndërkombëtar ekspertët vlerësojnë se kur merren parasysh rrethanat në të cilat stafi punon, gjendja nuk është aq e keqe, por rekomandojnë që të rriten mundësitë e involvimit të stafit në punë hulumtuuese. Lidhur me financat dhe infrastrukturën, në raport thuhet se ka plan buxhetor për fakultetin si tërësi, kurse ende nuk ka plan për programet, prandaj rekomandohet që menaxhmenti të përpiloj buxhet plane individuale për të gjitha programet. Gjithashtu, edhe sa i përket vlerësimeve interne të programeve, ekspertët rekomandojnë që alokimi i fondeve të jetë transparent. E për infrastrukturën rekomandohet që urgjentisht të përmirësohet.

Tri vite pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritë brenda kësaj kohe, kërkuam intervistë me dekanin But Dedaj, e edhe me prodekanin për çështje mësimore Driton Balaj, por nuk morëm përgjigje.

AKA:

“ Në vitin akademik 2014/15 kuota për pranimin e studentëve ishte 400, u pranuan 713 studentë. Kjo e afekton cilësinë e programit, sidomos kur dihet se profesorët kanë të drejtë të punojnë edhe në institucione tjera arsimore.

Dekani But Dedaj

Nuk ka pranuar të intervistohet.

AKA:

“Sa i përket literaturës, referencat janë shumë të vjetra, sidomos në lëndë teorike. Kjo ka të bëjë edhe me bibliotekën që është mjaft e varfër - gjatë vizitës në bibliotekë kemi parë mungesë të disa librave bazë të letërsisë shqipe.

Dekanja Lindita Sejdiu-Rugova

Nuk ka pranuar të intervistohet.

5. Fakulteti i Filologjisë letërsi shqipe

Sipas raportit final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në qershor 2016, programi 'letërsi shqipe' është në përputhje me misionin e institucionit dhe me nevojat e tregut. Rekomandimet që dalin nga ky raport janë kryesisht për kurrikulën/programin mësimor të këtij drejtimi⁸.

Rekomandimi i parë ka të bëjë me numrin e afateve të provimeve. Sipas ekspertëve ka afate të tepërta, prandaj duhet të reduktohen në maksimum tre afate. Gjithashtu, raporti thotë se është shumë e nevojshme që profesorëve t'u ofrohet ndihmë për të bërë hulumtime dhe për të krjuar më shumë lidhje/raporte ndërkombëtare. Sa i përket literaturës, ekspertët vlerësojnë se referencat janë shumë të vjetra, sidomos në lëndë teorike. Mirëpo, sipas tyre kjo ka të bëjë edhe me bibliotekën që është mjaft e varfër - ekspertët theksojnë se gjatë vizitës së tyre në bibliotekë panë mungesën e disa librave bazë të letërsisë shqipe.

Për kurrikulën e programit, raporti thotë se është ndër-tuar duke kombinuar katër kriteret ose metoda të studimit të letërsisë: zhanret, historike, gjeografike dhe tematike. Mirëpo, sipas ekspertëve pjesa teorike dhe historike nuk janë të balancuara mirë për shkak se pjesa më e madhe e lëndëve në program janë teorike. Disa nga rekomandimet për këtë pjesë të raportit janë që të mos ketë përsëritje të lëndëve që ligjërohen në mënyrë më specifike. Po ashtu, raporti rekomandon që disa lëndë të jenë zgjedhore, e jo obligative dhe anasjelltas.

Dy vite pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritë brenda kësaj kohe, kërkua të intervistojmë dekanën Lindita Sejdiu-Rugova, por nuk morëm përgjigje.

⁸ Asllani, P, et al. «University of Prishtina Faculty of Philology Reaccreditation Report», faqe 43-47, Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2016.

6. Fakulteti Filozofik punë sociale

Sipas raportit final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në qershor 2016, drejtimi 'punë sociale' në Kosovë është shumë i nevojshëm dhe në të ardhmën duhet të përpunohet konform nevojave të shoqërisë⁹. Sa i takon programit akademik, ekspertët kanë disa rekomandime: studentët të fillojnë praktikën më herët gjatë studimeve, e jo si deri më tani vetëm në semestrin e fundit; të formalizohen marrëveshjet me qendrat për punë sociale dhe OJQ-të e ndryshme sa i takon praktikës së studentëve, sepse nuk mjaftojnë vetëm marrëveshjet verbale; të përzgjedhën me kujdes mentorë (instruktorë terreni) që t'i monitorojnë studentët gjatë punës së tyre praktike.

Lidhur me kurrikulën, modulet, njësitet dhe literaturën, në raport rekomandohen ndryshime të cilat do të ndikojnë në ngritjen e cilësisë së programit. Vërejtja e parë është se studentët nuk mund të zgjedhin nga një lëndë zgjedhore sipas dëshirës nga programet e tjera, pavarësisht se një gjë e tillë figuron në teori. Ekspertët theksojnë se në këtë program nuk ofrohet asnjë lëndë në gjuhën angleze, e cila nuk është kriter për t'u pranuar në këtë drejtim, gjë që e limiton ndërkombëtarizimin e këtij drejtimi, andaj ata rekomandojnë që mësimi i anglishtes të përfshihet në program. Rekomandimi tjetër është të pajiset biblioteka me literaturë të punës sociale, meqë sipas ekspertëve aty nuk ka asnjë libër për këtë program. Gjithashtu, duhet rishqyrtuar renditjen e disa lëndëve se cilat mësohen në vit të parë, e cilat në të dytin.

Sa i takon hulumtimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, raporti tregon se departamenti i punës sociale i ka kështu rëndësi punës hulumtuese - pothuajse gjithë studentët duhet të bëjnë nga një ese hulumtuese në fund të

AKA:

“ Në këtë program nuk ofrohet asnjë lëndë në gjuhën angleze, e cila nuk është as kriter për t'u pranuar në këtë drejtim. Kjo e limiton ndërkombëtarizimin e këtij drejtimi, andaj rekomandojmë që mësimi i anglishtes të përfshihet në program.

⁹ Kovacevic, M., et al. «KAA Site Visit: Faculty of Philosophy», faqe 10-15, Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2016.

studimeve, mirëpo publikimi i tyre nuk është ende mjaft i përhapur, pasi edhe nuk ofrohen shumë mundësi për mësimdhënësit dhe studentët që të publikojnë hulumtime. Ekspertët rekomandojnë që të publikohen esetë hulumtuese të stafit dhe të studentëve. E sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar raporti thotë se janë disa bashkëpunime me Shqipërinë, Austrinë, Gjermaninë, Zvicrën dhe Skocinë. Po ashtu, sipas raportit, departamenti është pjesë e projektit ndërkombëtar Erasmus+ në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe anëtarët e stafit janë të anëtarësuar në rrjete të ndryshme ndërkombëtare. Megjithëkëtë, raporti rekomandon më shumë punë për bashkëpunime ndërkombëtare dhe për programe shkëmbimi për stafin dhe studentët.

Shefi i Departmentit Lulzim Dragidella:

“Sa i takon përfshirjes së anglishtes, e kemi pasur në program, por e kemi hequr, meqë nuk është lëndë profesionale dhe në vend të saj e kemi futur praktikën.

Lidhur me stafin akademik, ekspertët vlerësojnë se ka mjaft profesorë që kanë përvojë studimore jashtë vendit, por rekomandojnë që të inkuadrohen më shumë profesorë nga praktika sociale. Gjithashtu, ata rekomandojnë që të punohet më shumë në hulumtime ndërkombëtare, meqë në mungesë të stimulimit financiar profesorët nuk mund të japin më të mirën në këtë drejtim. Sa i takon infrastrukturës, sipas ekspertëve, fakulteti qëndron përgjithësisht mirë: ka mjaftueshëm klasa, salla e kabinete të pajisura me teknologjitë e nevojshme. Raporti rekomandon që të furnizohet biblioteka me literaturë për drejtimin ‘punë sociale’, të pajiset me internet, të rinovohet qasja në programin SPSS dhe të sigurohet qasja në databaza ndërkombëtare si EBSCO.

Dy vite pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritë brenda kësaj kohe, intervistua shefin e departamentit, profesor Lulzim Dragidella. Lidhur me rekomandimin e parë të ekspertëve që të inkuadrohet puna praktike më herët, Dragidella thotë se ka modele të ndryshme të organizimit të praktikës, por si departament kanë vlerësuar që praktika të jetë 100 ditë pune dhe të përfshihet në semestër të fundit. Sa i përket formalizimit të marrëveshjeve, ai tregon se janë në finalizim të

tyre dhe shton se deri tani nuk kanë pasur asnjë problem me qendrat sociale dhe OJQ-të e ndryshme. Kurse rreth mentorëve që do të monitoronin punën praktike të studentëve, ai sqaron se kjo është pak problematike meqë nuk ka profesionistë. Si ide është që të trajnohet së paku nga një person në institucionet dhe qendrat përkatëse, që do të mund të vlerësonte studentët gjatë praktikës, por edhe t'i udhëzonte duke krijuar një plan pune për ta, t'ua ndante detyrat, e me radhë.

Rreth rekomandimeve mbi kurrikulën, modulet, njësitë dhe literaturën, Dragidella sqaron se studentët mund të përzgjedhin lëndët zgjedhore në semestrin e tretë. E sa i takon përfshirjës së anglishtes, tregon se e kanë pasur në program, por e kanë hequr, meqë nuk është lëndë profesionale dhe në vend të saj e kanë futur praktikën. Për rekomandimin që të zhvendoset 'etika' në vit të parë, thotë se do ta zhvendosin deri në riakreditim.

Sa i takon hulumtimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, Dragidella thotë se është vështirë që të inkurajohen profesorët të hulumtojnë e të publikojnë meqë nuk mbështetën financiarisht. Sipas tij, është shumë e nevojshme të punohet në botimin e teksteve për 'punë sociale' në shqip, por është vështirë, meqë këto nuk do t'u shërbenin pjesëtarëve të stafit akademik as për avancime e as për ndonjë përfitimim material. Sa i përket bashkëpunimeve ndërkombëtare ai tregon se kanë bashkëpunim me Universitetin e Eegensbergut në Gjermani, që është partneri i tyre kryesor; studentët kanë mundësi të studiojnë një semester jashtë vendit përmes projektit Erasmus+, e me Universitetin Sterling të Skocisë kemi krijuar një modul mësimor për mbrojtjen e fëmijëve.

I pyetur se a ka profesorë nga 'praktika sociale', Dragidella sqaron se një gjë e tillë nuk është e mundshme shkaku i kufizimeve formale. Lidhur me infrastrukturën Dragidella tregon se internet ka në kabinete të profesorëve, por jo në salla, gjë që është e nevojshme për njësi të caktuara

mësimore. Për qasjen në platformën EBSCO, ai sqaron se kohëve të fundit është punuar në atë drejtim dhe se tani kanë akses në ‘Web of Science’¹⁰.

7. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës MA konstruksionet

AKA

“Janë rreth 200 studentë në programin ‘konstruksionet’, mirëpo prej tyre vetëm 5 diplomojnë në vit, prandaj ky është një disproporcion i çuditshëm për të cilin personat përgjegjës duhet të japin sqarime.

Sipas raportit final të AKA-së, i përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në qershor 2017, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës (FNA), pavarësisht se ka pasur ndryshime pozitive, ka ende punë për të bërë për t’i përmbushur rekomandimet e grupit të ekspertëve¹¹.

Sa i takon stafit, rekomandimi i parë është që në secilin program të garantohet të paktën nga një profesor me orar të plotë; rekomandimi i dytë ka të bëjë me rritjen akademike, e cila është shumë e ngadalshme për shkak të rregullave të UP-së; pastaj, termi ‘revistë shkencore ndërkombëtare’ nuk është i mirëdefinuar – a është revistë me impakt faktor? a është me ‘peer review’ – andaj, edhe procesi i rritjes akademike nuk është mjaft i qartë.

Për infrastrukturën, raporti vë në pah se është punuar dukshëm në këtë drejtim - ndërtesa kryesore e FNA-së është pothuajse në përfundim, mirëpo ka ende punë për tu bërë, sidomos rreth laboratoreve. Gjithashtu, pavarësisht se në akreditimin e fundit është theksuar nevoja e rregullimit dhe e furnizimit të bibliotekës, ajo nuk i përmbushë standardet europiane. Raporti thekson se janë rreth 200 studentë në programin ‘konstruksionet’, mirëpo prej tyre vetëm 5 diplomojnë në vit, e sipas ekspertëve ky është një disproporcion i çuditshëm për të cilin personat përgjegjës duhet të japin sqarime.

¹⁰ Intervistë me Lulzim Dragidellën, shef i departamentit për punë sociale në Fakultetin Filozofik, 31 tetor 2018.

¹¹ Dombay, Gábor dhe Kruis Jaroslav «Report on the Expert Team on Re-Accreditation Procedure of Master Progeams at Faculty of Civil Engineerings and Architecture, University of Prishtina», faqe 1-5, Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2017.

Për hulumtimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar fakulteti nuk qëndron keq. Ekspertët vlerësojnë që punime të disa pjesëtarëve të stafit akademik janë publikuar në databaza të njohura ndërkombëtarisht. Gjithashtu, ka bashkëpunim me institucione të ndryshme të vendeve fqinje - ka studentë të PhD-së në Milano, Shkup, Sarajevë dhe Tiranë, kurse herë pas here mbahen edhe ligjerata nga këto institucione. Sa i takon programit akademik, raporti thotë se ka raste kur lëndët dhe përshkrimi i tyre nuk janë konsistent, andaj rekomandojnë që kjo të rregullohet e të evitohen paqartësitë. Po ashtu, raporti thekson se 50% e lëndëve obligative ligjërohen nga pjesëtarë të stafit të fakulteteve të tjera, andaj rekomandon që më shumë lëndë të ligjërohen nga stafi i rregullt i FNA-së.

Një vit pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritur brenda kësaj kohe, intervistua dakanin Abdullah Zejnullahu, i cili tha se rekomandimet për stafin akademik janë përmbushur, në frymën e nenit 175, 176 dhe 177 të Statutit të UP-së dhe në pajtim me Rregullorën Nr. 465 (paragrafi A, shtojca II). Ndërkaq, rreth infrastrukturës, tha se rreth 2000 m², hapësirë kjo për mësimdhënie, e cila është në kuadër të objektit të laboratoreve (jashtë objektit qendror të Fakulteteve Teknike), janë pothuajse në përfundim dhe shtoi se laboratorët janë në furnizim e sipër me pajisje. Po ashtu, janë duke u renovuar edhe hapësirat e brendshme të objektit të Fakulteteve Teknike, si: tualetet, suvatosja e hapësirave të përbashkëta, korridoreve, shkallëve; gjithashtu janë duke u renovuar edhe hapësirat e objektit të Departamentit të Arkitektures (DA), si: modelariumi, laboratorit dhe hapësirat e brendshme të objektit qendror të DA-së. Sa i takon qasjes në revista ndërkombëtare tregoi se sapo e kanë marrë një njoftim nga Universiteti se do të kenë qasje në një bazë të revistave akademike ‘Science Direct’.

Sipas dekanit, shpërputhja e numrit të studentëve që janë në këtë program dhe atyre që diplomojnë ndodhë për shkak se gjatë studimeve MA, pjesa më e madhe e stu-

Dekani Abdullah Zejnullahu:

“ Shpërputhja e numrit të studentëve që janë në këtë program dhe atyre që diplomojnë ndodhë përshkak se gjatë studimeve MA, pjesa më e madhe e studentëve gjejnë vende pune dhe nuk u ngutet që t’i përfundojnë studimet në kohë. Po ashtu, ky numër (200 i cituar) tregon grumbullimin e disa gjeneratave, meqë në gjeneratë regjistrohen nga 20-30 studentë për departament/program studimor.

dentëve gjejnë vende pune dhe nuk u ngutet që t'i përfundojnë studimet në kohë. Po ashtu, ky numër (200 i cituar) tregon grumbullimin e disa gjeneratave, meqë në gjeneratë regjistrohen nga 20-30 studentë për departament/programme studimore. Për më shumë, nga korriku 2017 e deri më tani 18 kanë përfunduar kandidatë studimet e nivelit MSc në programin konstruktiv, e që paraqet një rritje të dukshme të numrit të të diplomuarëve në studimet MSc. Për bashkëpunimet ndërkombëtare, dekani thotë se kanë punuar në këtë drejtim - përveç me Universitetin e Dortmundit, është arritë bashkëpunim edhe me Universitetin e Amsterdemit, e të Budapestit, të Dessaut në Gjermani. Lidhur me rekomandimin e fundit, dekani thotë se përshkrimi i lëndëve tani është konsistent, kurse sa i takon asaj se kush i ligjëron lëndët bazë ai shton se kjo rregullohet nga stafi i rregullt i FNA-së, sepse në këtë periudhë kohore është shtuar numri i profesorëve me orar të rregullt, për 5 profesorë asistentë¹².

8. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

inxhinieri kompjuterike

Raporti final i AKA-së, i përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në qershor 2014, fillon me vërejtje të përgjithshme për fakultetin, por që lidhen me drejtimin inxhinieri kompjuterike¹³. Fillimisht, ekspertët vlerësojnë se numri i afateve të provimeve nuk duhet të jetë më shumë se tre në vit. Pastaj, ekspertët konstatojnë se ka pak specializim në programet BA, prandaj rekomandojnë të krijohet më shumë diferencë mes programeve.

¹² Intervistë me Abdullah Zejnullahun, Dekan i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, 18 tetor 2018.

¹³ Berroth, M., et al. «Raporti i vlerësimit për Universitetin e Prishtinës», faqe: 6-10, 12, 18-21, Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2014.

Për përzgjedhjen dhe pranimin e studentëve, raporti sqaron se procedurat për pranimin e studentëve të rinjë (suksesi në shkollë të mesme dhe rezultati i testit të maturës) janë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Mirëpo, problematik del të jetë fakti se jo domosdoshmërisht testi kombëtar i maturës reflekton përgatitjen e studentëve për drejtimet përkatëse të fakultetit, andaj grupi i ekspertëve e mbështetë propozimin e menaxhmentit për përsëritjen e provimeve pranuese. Gjithashtu, raporti thekson se inxhinieria kompjuterike është programi që tërheq më së shumti studentë, e kjo shkakton mbingarkesë të programit, andaj menaxhmenti duhet të dedikojë më shumë burime.

Për programin akademik, raporti thekson se pjesa më e madhe e atyre që diplomojnë në inxhinieri kompjuterike fillojnë punën në drejtimet zhvillim të softuerit apo inxhinieri softuerike, pavarësisht faktit se kurrikula është larg kësaj fushe. Po ashtu, programi ofron mundësinë e specializimit në dy degë të ndryshme, njëra nga të cilat është bazat e të dhënave dhe inteligjencë artificiale, kurse lënda e vetme që lidhet me inteligjencën artificiale është zgjedhore, e që i bie se studenti pasi të përfundoj inxhinierinë kompjuterike mund të vazhdoj specializimin në drejtimin e lartpërmendur pa ndjekur asnjë ligjeratë mbi inteligjencën artificiale paraprakisht.

Për hulumtimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, raporti konstaton se ka akoma punë për t'u bërë dhe rekomandon që të inkurajohet stafi për përfshirje në hulumtime, projekte e bashkëpunime me qëllim që të rritet cilësia e mësimdhënies, reputacioni i fakultetit dhe të përmirësohet aspekti financiar. Për financat dhe infrastrukturën, raporti pohon se buxheti në dispozicion nuk përputhet me numrin e studentëve, infrastruktura është e papërshtashme dhe e pamjaftueshme. Ekspertët tregojnë se fakultetet teknike në BE kanë mundësi që të tërheqin fonde të mëdha nga institucione qeveritare, fondacione, kompani industriale, e me radhë, dhe sugjerojnë se këto mundësi do të mund t'i përmirësonin kushtet në

AKA:

“ Buxheti në dispozicion nuk përputhet me numrin e studentëve, infrastruktura është e papërshtashme dhe e pamjaftueshme.

Dekani Enver Hamiti

“Kemi telashe të mëdha me staf akademik për shkak të kufizimeve buxhetore dhe mungesës së ekspertëve që do të mund t'i plotësonin nevojat - nga viti akademik 2013/14, 10 mësimdhënës kanë dalë në pension.

këtë fakultet. Për menaxhimin e cilësisë raporti tregon se programet e FIEK-ut vlerësohen rregullisht sipas standardeve të AKA-së, mirëpo profesorët nuk marrin vlerësimet që bëhen nga studentët, prandaj ekspertët rekomandojnë që studentët dhe stafi të marrin rezultatet e vlerësimit të lëndëve.

Katër vite pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritur brenda kësaj kohe, intervistua dakanin Enver Hamiti. Sa i takon afateve të provimeve Dekani sqaron se sipas statutit janë tri afate të rregullta. Lidhur me vërejtjen e ekspertëve se ka pak specializim në programet e nivelit BA, Dekani thotë se pas konsultimeve të shumta e kemi ridizajnuar kurrikulën me ç'rast, falë bashkëpunimit në mes të ekspertëve dhe stafit akademik, kemi akredituar programin për elektroenergetikë. Rreth testit kombëtar të maturës dhe provimit pranues, dekani tregon se ka kohë që është rikthyer testi pranues, meqë sistemi i bazuar vetëm në test kombëtar nuk ka funksionuar - kishte raste kur nxënësit që kishin sukses relativisht të dobët në shkollë të mesme arrinin pikë të larta në test kombëtar, gjë që reflektohej pastaj gjatë studimeve.

Se a ka dedikuar fakulteti më shumë burime për drejtimin 'inxhinieri kompjuterike', dekani thotë se ka telashe të mëdha me staf akademik për shkak të kufizimeve buxhetore dhe mungesës së ekspertëve që do të mund t'i plotësonin nevojat - nga viti akademik 2013/14, 10 mësimdhënës kanë dalë në pension. Për vërejtjet dhe rekomandimet e ekspertëve lidhur me kurrikulën, dekani thotë se në këtë pikë ndodhin devijime për shkak se propozimet për lëndë bëhen në nivel departamentesh, e nganjëherë nuk ka koordinim sa duhet – këto probleme do të rregullohen deri në akreditimin e ardhshëm.

Për hulumtimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, dekani thotë se kanë krijuar programe të mobilitetit e të shkëmbimeve dhe të hulumtimeve. Madje, sipas tij, edhe studentët angazhohen në hulumtime shkencore bashkë

me profesorët (në kuadër të temave të kandidatëve). Për financat dhe infrastrukturën dekani thotë se qëndrojnë keq, mirëpo, çështja e financave dhe infrastrukturës duhet trajtuar në nivel qendror, meqë këto janë të centralizuara. Ai tregon se aplikojnë në kuadër të projekteve ndërkombëtare dhe se përfitimet kryesore nga ato janë në infrastrukturën laboratorike. Lidhur me vërejtjen se profesorët nuk i marrin rezultatet e vlerësimeve, ai thotë se vlerësimet procesohen në nivel qendror¹⁴.

9. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike komunikacion dhe transport

Sipas raportit final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në qershor 2017, programi 'komunikacion dhe transport' është në përputhje me misionin e institucionit si dhe ka numrin më të lartë të studentëve në nivelin BA nga të gjitha programet e tjera.¹⁵

Sa i takon programit akademik dhe menaxhimit të studentëve, vërejtja e parë ishte për numrin e madh të studentëve - afërsisht 120 studentë regjistrohen çdo vit në komunikacion dhe transport, e vetëm 10% e tyre diplomojnë, andaj është vlerësuar pozitivisht ulja e numrit të studentëve që pranohen - 90 studentë.

Për kurrikulën e programit, raporti thekson se është i mirë dizajnuar dhe i balancuar, mirëpo duke pasur parasysh se problemet e ndotjes dhe cilësia e ajrit janë tema të rëndësishme, rekomandohet që të inkorporohet një lëndë që ka të bëjë me aspektin mjedisor të trafikut. Sipas ekspertëve, ECTS-të dhe ndarja e kredive nuk janë të shpërndara në mënyrë të balancuar, andaj duhet të rishqyrtohet shpërndarja e ECTS-ve në raport me numrin e

¹⁴ Intervistë me Enver Hamitin, Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, 16 tetor 2018.

¹⁵ Grogger H., et al. «Final Report», faqe 6-12, Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2017.

AKA:

“ Sa i përket hulumtimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, fakulteti qëndron relativisht mirë. Fakti që studentët marrin pjesë në hulumtime është gjithashtu për tu përshëndetur.

AKA:

“ Lidhur me financat dhe infrastrukurën janë bërë ndryshime të dukshme: buxheti për pajisje laborike është rritur për 400 mijë euro, është planifikuar të bëhet zgjerimi i bibliotekës dhe objekti kryesor i FIM-it është modernizuar.

orëve. Po ashtu, lëndë të njëjta që figurojnë në programe studimore të ndryshme duhet që të kenë numër të njëjtë të kredive. Në vazhden e kësaj, ekspertët sugjerojnë që të ketë afate më të shpeshta të provimeve (5-6), e jo vetëm në fund të semestrave si është tani. Gjithashtu, ata vlerësojnë se mosnjohja e gjuhës angleze limiton shumë studentët dhe për këtë ata rekomandojnë që në provimin pranues të përfshihen pyetje edhe nga gjuha angleze. Kurse rezultatet e provimeve pranuese rekomandojnë që të përdorën për analiza statistikore.

Sa i përket hulumtimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, raporti vlerëson se fakulteti qëndron relativisht mirë dhe shton se duhet të vazhdohet në këtë mënyrë. Fakti që studentët marrin pjesë në hulumtime është gjithashtu për tu përshëndetur.

Lidhur me financat dhe infrastrukurën, raporti thotë se janë bërë ndryshime të dukshme: buxheti për pajisje laborike është rritur për 400 mijë euro, është planifikuar të bëhet zgjerimi i bibliotekës dhe objekti kryesor i FIM-it është modernizuar. Rekomandimi i vetëm për këtë pjesë është që një pjesë e buxhetit të ndahet për t'i modernizuar pajisjet kompjuterike për studentë dhe për të përfunduar renovimet në bibliotekën e fakultetit.

Një vit pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritë brenda kësaj kohe, intervistuaam prodekanin Ilir Doçi. Rreth komentit të ekspertëve lidhur me numrin e studentëve, prodekani sqaron se nga viti 2016 nuk pranojnë më shumë se 90 studentë dhe shton se ka vite që afërsisht 30% e kandidatëve që regjistrohen arrijnë diplomimin. Gjithashtu, i pyetur se a është inkorporuar ndonjë lëndë që ka të bëjë me aspektin mjedisor të trafikut, prodekani tregon se lënda komunikacioni dhe mjedisi është pjesë e programit që nga viti akademik 2011/12 dhe shton se kjo nuk është e vetmja. E lidhur me vërejtjet për ndarjen e kredive prodekani tregon se këto probleme tashmë janë rregulluar.

Sa i përket rekomandimit të ekspertëve që të ketë më shumë afate të provimeve gjatë vitit, prodekani thotë se kjo është e rregulluar me statut - janë tri afate dhe ne u përmbahemi, e çdo afat tjetër mbahet me leje të senatit. Mirëpo, duhet theksuar që sipas prodekanit, afatet shtesë nuk kontribuojnë aspak në cilësinë e arsimit. I pyetur se a janë përfshirë pyetje nga gjuha angleze në testin pranues, prodekani tregon që gjuha angleze përfshihet në provimin pranues në master dhe jo në bachelor, dhe sqaron se anglishtja tani është lëndë obligative në dy semestra. Në vazhdim të kësaj, njohja e gjuhës angleze është e mirëseardhur por nuk po kërkohet patjetër në vendet ku punojnë. Ajo që kërkohet më shumë është aftësimi sa më i mirë profesional. Po ashtu, ai sqaron se rezultatet e provimeve pranuese përdorën për analiza statistikore meqë u shërbejnë për t'i analizuar trendet.

Lidhur me hulumtimet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, prodekani tregon se stafi është mjaft i involvuar në hulumtime dhe shumë punë bëhen bashkë me studentë. Ai tregon se kanë pasur projektin me JICA, organizatë japoneze, për matjen e ndotjes së ambientit. Gjithashtu kanë pasur projektin ALLED të BE-së si dhe një ADA, që kishte të bënte me mekatronikë, në të cilin kanë marrë pjesë edhe studentët. Prodekani thotë se ka pasur edhe disa projekte e bashkëpunime tjera, e aktualisht kanë bashkëpunime me të paktën tetë fakultete të ndryshme të rajonit dhe më gjërë. Sa i takon financave dhe infrastrukturës, prodekani tregon se janë furnizuar dy laboratore me kompjuterë të rinjë që i plotësojnë kërkesat për mësimin me kompjuterë. Sipas tij, zgjerimi i hapësirës së bibliotekës në ndërtesën e Fakulteteve Teknike është i nevojshëm.¹⁶

Prodekani Ilir Doçi:

“Lidhur me hulumtimet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare, stafi është mjaft i involvuar në hulumtime dhe shumë punë bëhen bashkë me studentë. Aktualisht kemi bashkëpunime me të paktën tetë fakultete të ndryshme të rajonit dhe më gjërë. Sa i takon financave dhe infrastrukturës, kemi furnizuar dy laboratore me kompjuterë të rinjë që i plotësojnë kërkesat për mësimin me kompjuterë.

¹⁶ Intervistë me Ilir Doçin, prodekan i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, 23 tetor 2018.

10. Fakulteti Juridik juridik i përgjithshëm

AKA:

“Sa i takon pjesës akademike, ku përfshihen: programet, modulet, syllabuset, ndarja e kredive, metodat e mësimdhënies, standardet ndërkombëtare, e me radhë, teorikisht ky drejtim qëndron mirë, por kemi dyshime nëse mund të përmbushen këto standarde të larta në praktikë.

Raporti final i AKA-së, i përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në maj të vitit 2017, vlerëson se ka pasur progres të vazhdueshëm që nga procesi i riakreditimit më 2009, 2012 dhe 2015. Mirëpo, në këtë raport thuhet se në riakreditimin e vitit 2015 u raportua se problemi kryesor i këtij programi është numri i studentëve, e sidomos lidhja studentë - nevojë e tregut, dhe përpjesa studentë-infrastrukturë dhe studentë-staf akademik. Andaj, ekspertët rekomandonin uljen e numrit të studentëve të rinj. Në mënyrë që procesi i reduktimit të numrit të studentëve të jetë serioz dhe profesional, ekspertët rekomandonin që stafi të bëjë një hulumtim lidhur me nevojën aktuale të tregut për avokatë e juristë – mirëpo, ky rekomandim nuk është marrë parasysh.

Sa i takon pjesës akademike, ku përfshihen: programet, modulet, syllabuset, ndarja e kredive, metodat e mësimdhënies, standardet ndërkombëtare, e me radhë, raporti thekson se teorikisht ky drejtim qëndron mirë, por ekspertët kanë dyshime nëse mund të përmbushen këto standarde të larta në praktikë. Për pjesën e stafit akademik ekspertët deklarojnë se duket që Fakulteti Juridik qëndron mirë, por rekomandojnë që në procesin e riakreditimit, të prezatohet një plan zhvillimor i stafit për një periudhë tri vjeçare.

Po ashtu, ekspertët thonë se Juridiku qëndron përgjithësisht mirë edhe në hulumtime dhe bashkëpunime ndërkombëtare - pjesëtarët e stafit akademik kanë publikime të ndryshme dhe bashkëpunime të konsiderueshme ndërkombëtare. Por, studentët nuk janë të përfshirë në hulumtime e projekte bashkëpunimi, prandaj raporti rekomandon që deri në riakreditimin e radhës të punohet më shumë për përfshirjen e studentëve në hulumtime.

Për pjesën e financave dhe infrastrukturës, fakulteti nuk qëndron mirë, por duhet të kihet parasysh se plani buxhetor është i centralizuar nga universiteti, andaj fakulteti e ka të vështirë të vendosë vet për realizimin e programit. Infrastruktura nuk i përmbushë nevojat, madje edhe po të zvogëlohet numri i studentëve. Duhet theksuar se është raportuar progres nga fakulteti sa i përket rekomandimeve të akreditimit paraprak, lidhur rritjen e ulëseve në klasa, digjitalizimin dhe rindërtimin e amfiteatrit. Pra, pritet që në procesin tjetër të akreditimit të raportohet se sa progres është arritur në këtë drejtim. Sa i takon vlerësimin të profesorëve nga ana e studentëve, raporti rekomandon që të gjindet një metodë që të inkorporohen rezultatet e këtij vlerësimi në procesin mësimor me qëllim që të rritet kualiteti¹⁷.

Një vit pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritur brenda kësaj kohe, kërkuam të intervistojmë dekanin Haxhi Gashi e edhe prodekanin për çështje mësimore Besfort Rrecaj, por asnjëri nuk u përgjigjën.

11. Fakulteti i Mjekësisë mjekësia e përgjithshme

Raporti final i AKA-së, i përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në qershor të vitit 2016, paraqet një serë rekomandimesh për drejtimin e mjekësisë së përgjithshme.¹⁸ Rekomandimi i parë nga ekspertët është që të mos pranohen më shumë se 150 studentë për vit akademik; dhe të dyfishohen ECTS-të për punimin e diplomës nga 10 në 20. Në mënyrë që të përmirësohet cilësia e mësimdhënies, ekspertët bashkë me menaxhmentin konsidero-

Dekani Haxhi Gashi

Nuk ka pranuar të intervistohet.

¹⁷ Falterbaum, Johannes, et al. «Program Reaccreditation Procedure at University of Prishtina, Faculty of Law», faqe 9, Agjencia Kosovare e Akreditimit, maj 2017.

¹⁸ Paulmich, Markus, et al. «Report on the Site-Visit for the Re-Accreditation Academic Programs of the Faculty, University of Prishtina, Kosovo», faqe 9, Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2016.

jnë se duhet të krijohet laboratorit për biologji molekulare/gjenetikë. Për më shumë, ekspertët kërkojnë që të informohen se kur do të krijohen këto qendra: e-LAB, Qendër për Shkathtësi Klinike, Qendra Informuese për Barnat, si dhe krijimin e Pozitës së Facilitatorit Klinik Brenda stafit akademik.

AKA:

“ Sa i përket burimeve njerëzore është e nevojshme rritja e personelit, në mënyrë që të rritet cilësia e mësimdhënies. Udhëheqësia e UP-së nuk ka arritur ta zgjidhë këtë, prandaj krijimi i një Universiteti të Mjekësisë do të përmirësonte thelbësisht situatën.

Rekomandimi i dytë është për burimet njerëzore dhe vë në pah nevojën e rritjes së personelit, në mënyrë që të rritet cilësia e mësimdhënies. Raporti thekson se udhëheqësia e UP-së nuk ka arritur ta zgjidhë këtë, prandaj krijimi i një Universiteti të Mjekësisë do të përmirësonte thelbësisht situatën. Rekomandimi i tretë thekson nevojën e bashkëpunimeve ndërkombëtare të stafit dhe të studentëve, e për këtë ekspertët thonë se udhëheqësit e Fakultetit të Mjekësisë kishin ide të qarta dhe bindëse.

Rekomandimi i katërt është për financat dhe infrastrukturën, pasi ankesa e përgjithshme e studentëve dhe stafit akademik ishte mungesa e fondeve për hulumtime laboratorike dhe klinike. Një gjë e tillë jo vetëm se afekton drejtpërdrejt procesin mësimor, por edhe pamundëson shkollimin dhe hulumtimin e mëtejshëm të stafit akademik, prandaj ekspertët vlerësojnë financimin e dy laboratorëve prej projektit TEMPUS, por theksojnë se janë të pamjaftueshëm, sidomos për një shkollë mjekësore të nivelit evropian.

Dy vite pas raportit të AKA-së, për të parë sa progres është arritur brenda kësaj kohe, intervistua Prodekanin e Fakultetit të Mjekësisë, Fisnik Kurshumliu¹⁹. Për rekomandimin e parë, zvogëlimin e numrit të studentëve, Kurshumliu thekson se është aplikuar rekomandimi i ekspertëve që të pranohen jo më shumë se 150 studentë, por shton se, për arsye krejtësisht teknike, mund të ketë ndonjëherë luhatje shumë të vogla në numër. Sa i përket kredive të temës së diplomës, Kurshumliu tregon se është rekomanduar që të ketë më shumë se 10 ECTS, pra

¹⁹ Intervistë me Fisnik Kurshumliun, Prodekan i Fakultetit të Mjekësisë, 3 tetor 2018.

të rritet, por një gjë e tillë është e vështirë të realizohet praktikisht sepse pastaj lëndë të rëndësishme mbesin me pak ECTS kredi (dhe zvogëlimi i ECTS kredive sjell implikime direkte në numrin e orëve mësimore).

Për laboratorët dhe qendrat që ka rekomanduar AKA-ja, Kurshumliu tregon se është bërë progres – tash ka laborator të biologjisë molekulare dhe të gjenetikës, pastaj qendrat për hulumtime si, e-lab, Qendra për Aftësi Klinike, dhe Qendra Informuese për Barnat, janë establishuar dhe ka rreth një vit që janë aktive.

Sa i takon rekomandimit për rritjen e personelit akademik, Prodekanja Gloria Staka sqaron se Fakulteti i Mjekësisë duke u bazuar në Regulloren për plotësim ndryshim të Rregullores nr.2/486 të datës 11.9.2017 për të ardhura personale të personelit akademik, shtesat për funksion, honoraret dhe komisionet e përhershme në UP në konkursin e datës 27.04.2018 ka kërkuar 27 pozita për profesorë asistent, e të cilat janë aprovuar në tërësi nga menaxhmenti i universitetit. Deri tani janë emëruar 19 profesorë asistentë, 4 pozita tjera janë në proces (pritet që të emërohen në mbledhjen e radhës së Senatit të UP-së), kurse 4 pozitat tjera të kërkuara kanë dështuar meqë kandidatët nuk i kanë plotësuar kushtet për avansim. Po ashtu, Staka tregon fakulteti ka kërkuar një numër të konsiderueshm të asistentëve të rregullt, mirëpo për shkak se kjo konsiderohet pozitë e re dhe ka impakt në buxhetin e UP-së, janë aprovuar vetëm 8 pozita për asistentë.

Për rekomandimin e tretë, bashkëpunimet e institucionalizuara ndërkombëtare, prodekani tregon se kanë disa bashkëpunime përmes projekteve të Erasmus+, tri bashkëpunime aktuale janë me Universitetin Sapienza në Romë, Universitetin Masaryk në Çeki dhe me Universitetin Dartmouth në SHBA, e për momentin po shohin mundësitë e bashkëpunimit edhe me Universitete të Mjekësisë në Spanjë dhe në Itali. Gjithashtu Fakulteti i Mjekësisë ka bashkëpunime me Curtin University në

Prodekanja Gloria Staka:

“ Fakulteti i Mjekësisë ka kërkuar 27 pozita për profesorë asistent, të cilat janë aprovuar në tërësi nga menaxhmenti i universitetit. Deri tani janë emëruar 19 profesorë asistentë, 4 pozita tjera janë në proces e 4 pozita kanë dështuar meqë kandidatët nuk i kanë plotësuar kushtet për avansim.

Australi, me Universitetin e Milanos në Itali, me Universitetin e Derby në Britani të Madhe, me Universitetin e Linkoping në Suedi, me Universitetin e Edinburgut në Skotlandë, me Ghent University në Belgjikë, Universitetin e Vjenës në Austri, dhe shumë universitete në Turqi²⁰.

Ndërkaq, për rekomandimin e katërt, financat dhe infrastruktura, prodekanja Gloria Staka tregon se është bërë shumë punë në pajisjen e laboratorëve të fakultetit dhe shton se furnizimi me pajisje dhe material laboratorik është bërë konform buxhetit të ndarë nga UP-ja. Ndër progreset tjera, sipas saj, është edhe furnizimi dhe rivitalizimi i Labororit të Fizikës Mjekësore me Biofizikë dhe themelimi i Qendrës për Simulim dhe Zhvillim të Shkathësive Klinike. E sa i takon infrastrukturës, Staka thotë se janë në ndërtim e sipër të Dekanatit të Fakultetit të Mjekësisë dhe në fazën fillestare administrative për iniciimin e ndërtimit të godinës për degën e farmacisë²¹.

12. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit edukim fizik dhe sporti BA

AKA:

“ Problematika kryesore në Fakultetin e Sportit ka të bëjë me infrastrukturën, e cila është në disproporcion me numrin e studentëve.

Sipas raportit final i AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në maj 2016, gjendja në këtë fakultet është përgjithësisht e mirë, andaj dhe nuk ka shumë rekomandime për programin e edukimit fizik dhe sportit²². Për programin akademik, raporti thekson se është konform standardeve europiane, kurse rekomandimet kryesore janë për strukturën e studimeve dhe përshkrimin e moduleve. Lidhur me rekomandimin e parë, ekspertët sqarojnë se udhëzimet europiane për BA dhe MA sugjerojnë strukturën e studimit 3+2. Sa i takon përshkrimit të

²⁰ Intervistë përmes e-mailit me Gloria Staka, prodekane e Fakultetit të Mjekësisë, 13 nëntor 2018.

²¹ Intervistë përmes e-mailit me Gloria Staka, prodekane e Fakultetit të Mjekësisë, 15 tetor 2018.

²² Hamar, Susan, dhe Petry, Karen «Final Report », faqe 1-6, Agjencia Kosovare e Akreditimit, maj 2016.

moduleve, raporti thotë se nuk janë të sqaruara mirë dhe se objektivat dhe rezultatet janë të mangëta.

Për hulumtimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, ekspertët vlerësojnë se Fakulteti i Sportit lë shumë për të dëshiruar; aktivitetet hulumtuese janë larg standardeve europiane; nuk ka një plan strategjik për hulumtim; prandaj rekomandohet që menaxhmenti të zhvillojë një plan tre vjeçar të aktiviteteve me objektiva të qarta. Sa i takon bashkëpunimeve ndërkombëtare, ekspertët sugjerojnë që të punohet më shumë në krijimin e projekteve të përbashkëta me universitete të mirënjohura europiane, meqë sipas tyre, fakulteti ka bashkëpunime të kufizuara dhe atë kryesisht me vende të rajonit.

Për financat dhe infrastrukturën raporti thekson se në dokumentacionin që u është dhënë ekspertëve nuk është përfshirë plani buxhetor i fakultetit. Megjithatë, problematika kryesore në Fakultetin e Sportit ka të bëjë me infrastrukturën, e cila është në disproporcion me numrin e studentëve. Gjithsej ka tri auditoriume, një sallë për gjimnastikë arsitike, një të sportit, një fitnes dhe një laborator të vogël – të gjitha këto të pamjaftueshme për të zhvilluar pjesën praktike. E sa për menaxhimin e cilësisë, ekspertët theksojnë se nuk ka rezultate të vlerësimeve dhe sqarojnë se janë informuar se UP-ja është përgjegjëse për procesimin e pyetësorëve.

Dy vite pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritë brenda kësaj kohe, intervistua dekanin Musa Selimi. Lidhur me përshkrimet e moduleve, dekani pajtohet me konstatimit e ekspertëve dhe tregon se kanë bërë një standard të përshkrimeve të syllabuseve, ku janë të sqaruara rezultatet dhe përfitimet që studentët do të kenë në fund të semestrit, por shton se ato duhen bërë edhe më të qarta për studentët. Sipas tij, është shumë e rëndësishme që studentët të jenë të informuar për lidhjen tonë me tregun. Për këtë, dekani thotë se mungon një masterplan nga MASHT-i, që nënkupton analizë të mirë-

Dekani Musa Selimi:

“ Preokupimi kryesor është infrastruktura, e cila as për së afërmi nuk i përmbushë standardet ndërkombëtare, por tashmë Fakulteti i Sportit është në listen e tri fakulteteve të UP-së që duhen ndërtuar urgjent, bashkë edhe me FShMN-në dhe Ekonominë.

Dekani Musa Selimi:

“ Është shumë e rëndësishme që studentët të jenë të informuar për lidhjet tonë me tregun. Për këtë mungon një masterplan nga MASHT-i, që nënkupton analizë të mirëfilltë të tregut për secilin profil.

filltë të tregut për secilin profil. Lidhur me rekomandimin e ekspertëve që studimet të jenë 3+2, sipas Kartës së Bolonjës, dekani thotë se niveli BA për momentin është 4 vite, por duhet parë se si duhet bërë në të ardhmen.

Rreth hulumtimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare, dekani thotë se nuk është e lehtë të inkurajohen profesorët që të merrën me hulumtime, meqë shpenzimet duhet t'i mbulojnë vet. Kurse për bashkëpunimet ndërkombëtare, ai thotë se gjashtë vite kanë pasur bashkëpunime me projektin TEMPUS, e pastaj edhe me IPA, kurse këtë vit kanë qenë bashkorganizatorë të një konference ndërkombëtare shkencore në Opati të Kroacisë.

Për planin buxhetor, dekani thotë se janë në përfundim të një plani për pesë vitet e ardhshme ku do të theksohen prioritetet, pikat e forta të implementimit dhe dobësitë. Sipas tij, preokupimi i tyre kryesor është infrastruktura, e cila as për së afërmi nuk i përmbushë standardet ndërkombëtare, por tashmë Fakulteti i Sportit është në listën e tri fakulteteve të UP-së që duhen ndërtuar urgjent, bashkë edhe me FShMN-në dhe Ekonominë. E lidhur me rezultatet e vlerësimeve të profesorëve, dekani konfirmon se ato procesohen në nivel qëndror dhe se nuk është në dijeni pse ato nuk u shpërndahen fakulteteve.²³

²³ Intervistë me Musa Selimin, Dekan i Fakultetit të Sportit dhe Edukimit Fizik, 26 tetor 2018.

13. Fakulteti i Shkencave Matematikë-Natyrore matematika

Raporti final i AKA-së, i përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në maj 2017, paraqet një serë rekomandimesh për drejtimin e matematikës²⁴. Rekomandimi i parë ka të bëjë me programin akademik dhe menaxhimin e studentëve. FShMN-ja është institucioni i vetëm që ofron programe studimore të matematikës të nivelit universitar, por ato nuk marrin parasysh disa iniciativa strategjike të “Strategjisë dhe Planit të Veprimit të UP-së”: implementimi i programeve në përputhje me nevojat e tregut, zhvillimi i rezultateve të matshme të programeve dhe rritja e bashkëpunimit me sektorin publik e privat për të përshtatur drejtimet e studimeve me kërkesën. Te kjo e fundit është rekomanduar të merret parasysh që rreth 80% e të diplomuarëve (BA) vazhdojnë studimet për t’u bërë mësues të matematikës, e niveli BA i studimeve nuk e merr në konsideratë këtë.

Sa i takon kredive, raporti vë në pah se ka mospërputhje mes lëndëve obligative dhe zgjedhore sa i takon numrit të ECTS-ve. Gjithashtu, ka lëndë të cilat kanë numër të lartë të kredive, por që konsiderohen të parëndësishme, dhe ka lëndë që janë të vetmet të kësaj fushe obligative, por që kanë numrin më të vogël të ECTS-ve. Lidhur me përpjesën staf-studentë, sipas kalkulimeve të ekspertëve, me 19 pjesëtarë të rregull të stafit akademik dhe 8 me orar të pjesshëm, raporti profesor-studentë nuk qëndron keq, mirëpo ata thonë se ka pasur ankesa nga profesorët për vëllim të madh pune e mungesë të stafi.

Për hulumtimin dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, ekspertët thonë se pjesa më e madhe e stafit merren me hulumtime të rregullta. Madje, lidhshmëria mes lëndëve që ata ligjerojnë dhe fushës së tyre të hulumtimit, mund të

AKA:

“ Lidhur me përpjesën staf-studentë, me 19 pjesëtarë të rregull të stafit akademik dhe 8 me orar të pjesshëm, raporti profesor-studentë nuk qëndron keq, mirëpo ka pasur ankesa nga profesorët për vëllim të madh pune e mungesë të stafit.

²⁴ Normal, Peeter dhe Krajacic, Mladen. «Evaluation Report», faqe 5-10, Agjencia Kosovare e Akreditimit, maj 2017.

cilësohet e mirë, mirëpo sipas ekspertëve, profesorët merren kryesisht me hulumtime, por shumë rrallë publikojnë hulumtime si bashkautorë. Prandaj, në raport rekomandohet që të definohen prioritetet në sferën e hulumtimeve dhe të formohen grupe hulumtuese, duke fokusuar aktivitetet në bazë të prioriteteve të tematikave. Sa i takon bashkëpunimit ndërkombëtar ekspertët bëjnë me dije se mentalisht nuk ka asnjë projekt hulumtues ndërkombëtar.

Dekani Tahir Arbnesi:

“Ka mjaft profesorë për drejtimin e matematikës, sikur mos të shpërndaheshin nëpër institucione tjera arsimore, por gati të gjithë profesorët janë të angazhuar edhe në të paktën një institucion tjetër. Për rrjedhojë, rrallë mund të gjenden profesorët në fakultet, gjë që po e dëmton ndjeshëm procesin mësimor.

Për problematikën tjetër, financat dhe infrastruktura, raporti konstaton gjendje të rëndë - nuk ka resurse për të zhvilluar veprimtari hulumtuese - dhe rekomandon të krijohet një fond, në nivel fakulteti ose universiteti për të mbështetur hulumtimet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare. Vërejtja e fundit e raportit ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë, e sipas ekspertëve, raporti i vetvlerësimit përmbante gabime të shumta gramatikore e teknike, gjë që tregon qartë nivelin e kontrollit të cilësisë.

Një vit pas raportit të AKA-së, për të parë se sa progres është arritë brenda kësaj kohe, intervistua dekanin Tahir Arbneshin. Sa i takon pikës së parë, dekani thotë se përgjegjëse për arsim në nivel vendi është MASHT-i, që duhet të sigurojë se programet e studimeve të fakulteteve përkatëse janë në përputhje me nevojat e tregut. Mirëpo, sa i takon programit të matematikës, dekani Arbneshi thotë se çdo i diplomuar në matematikë ka vend pune të garantuar për dhjetë vitet e ardhshme. Lidhur me zhvillimin e rezultateve të matshme, ai thotë që kjo ndodhë për shkak se fakulteti është shumë heterogjen, funksionojnë pesë departamente ku ofrohen nëntë programe në nivelin bachelor (BA), tetë në nivelin master dhe dy të doktoratës, e sfida kryesore është hartimi i raporteve të vetvlerësimit. Sipas tij, vështirësitë kryesore janë menaxhimi i syllabuseve, meqë hartohen në mënyrë vetanake nga profesorët, ndërsa shton se me asnjë përshkrim të detyrave nuk mund të ndikoj në këtë proces. I pyetur se a merren parasysh nevojat e mësuesve të matematikës, dekani sqaron se që nga viti 2012 është marrë vendimi për bartjen

e programeve arsimore në edukim, që i bie se një student i matematikës duhet t'i përfundoj tri vite në fakultetin e shkencave dhe dy tjera në atë të edukimit që të bëhet mësimdhënës i matematikës. E kjo sipas tij nuk është treguar e suksesshme dhe ka dëmtuar rëndë FShMN-në.

Lidhur me vërejtjet e ekspertëve rreth ndarjes së kredive, dekani thotë se AKA-ja ka të drejtë. Ai tregon se si fakultet janë në hall me matematikën pasi që ka dy vite që po akreditohet me kusht. Dekani sqaron se është munduar që të ndikojë te ky program, por thotë se asnjë nga sugjerimet e tij nuk është pranuar. Sipas tij, FShMN-ja do duhej të merrte për bazë programet e Universitetit e Lublanës, meqë rangohet në 1000 fakultetet e para në rajon dhe është në BE.

Dekani thotë se ka mjaft profesorë për drejtimin e matematikës, sikur mos të shpërndareshin nëpër institucione tjera arsimore, por gati të gjithë profesorët janë të angazhuar edhe në të paktën një institucion tjetër, e për rrjedhojë rrallë mund të gjenden profesorët në fakultet, gjë që po e dëmton ndjeshëm procesin mësimor.

Sa i takon hulumtimeve dhe bashkëpunimeve ndërkom-bëtare, ai thotë se është natyra e matematikës që ndikon që profesorët të publikojnë vet, e jo bashkarisht. Sipas tij, që nga viti 2012 nuk pasë ndonjë projekt shkencor në departamentin e matematikës. Sa i përket rekomandimit të ekspertëve që të formohen grupe që të punojnë në hulumtimet e prioritizuara, dekani sqaron që ky në fakt është prioriteti numër një. Sipas tij, grupet e punës duhet të jenë të lidhura me lëminë e studimeve/vendin e punës. Shembull, matematika ka analizë, algjebër e të tjera, nga këto fusha duhet me qenë një hulumtues, i cili dhe do t'i printe grupit punues. Pra, profesori i një fushe të caktuar është udhëheqës i grupit i cili identifikohet me atë fushë²⁵.

²⁵ Intervistë me Tahir Arbneshin, Dekan i Fakultetit të Shkencave Matematiko-Natyrore, 24 tetor 2018.

Përfundime

- Për burimet njerëzore, AKA-ja ka dhënë rekomandime ose vërejtje për 4 fakultete. Prej tyre, 2 fakultete (FNA-ja dhe Mjekësia) i kanë zbatuar rekomandimet, e 2 tjera - FIEK-u ('inxhinieria kompjuterike') dhe FShMN-ja ('matematika') - nuk i kanë zbatuar. Në drejtimin e 'inxhinierisë kompjuterike' thonë se rekomandimi për burime njerëzore nuk është zbatuar për shkak të kufizimeve buxhetore dhe mungesës së ekspertëve në nivel vendi, e në drejtimin 'matematikë', thonë ky rekomandim nuk është zbatuar, ngaqë pjesa më e madhe e stafit të këtij drejtimi janë të angazhuar në të paktën edhe një institucion tjetër të arsimit, e për rrjedhojë rrallë mund të gjenden profesorët e këtij drejtimi në fakultet. Po ashtu, për 2 fakultete AKA-ja e ka potencuar si problem serioz angazhimin e stafit akademik në institucione tjera, por deri më tani asgjë nuk është ndërmarrë për ta ndalur këtë.
- Lidhur me infrastrukturën, AKA-ja ka dhënë rekomandime ose vërejtje për 10 fakultete, e për 5 prej tyre ka konstatuar se gjendja është e rëndë. Nga intervistat me dekanë kuptuam se 3 fakultete janë në listë urgjente për ndërtim - Ekonomia, FShMN-ja dhe Sporti - por, deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim.
- Për 4 fakultete AKA-ja ka rekomanduar decentralizimin e buxhetit, duke e konsideruar gjendjen aktuale problem qëndror, por deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim. Po ashtu, për 3 fakultete (Mjekësia, Edukimi dhe Artet) AKA-ja, e madje edhe menaxhmentet e këtyre fakulteteve, kanë sugjeruar idenë e decentralizimit të tërësishëm, por për këtë nuk është ndërmarrë asgjë.
- Rreth hulumtimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare AKA-ja ka dhënë rekomandime ose vërejtje

për 7 fakultete: të bëhet më shumë punë hulumtuese dhe të përfshihen studentët; të punohet më shumë në bashkëpunime ndërkombëtare dhe në shkëmbime të stafit dhe të studentëve. Dekanët thonë se është vështirë të nxiten profesorët për hulumtime meqë nuk ka mbështetje financiare për këtë.

- Sa i takon programit akademik, për 10 fakultete AKA-ja ka dhënë rekomandime ose vërejtje lidhur me: ngjashmëritë ose përsëritjet e përmbajtjeve akademike; përshkrimet e pamjaftueshme, të paqarta ose të përgjithësuara të lëndëve. Dekanët thonë se kanë krijuar grupe punuese e se këto të meta do të rregullohen deri në akreditimin e radhës.
- Për 4 fakultete AKA-ja ka dhënë vërejtje që profesorët nuk i marrin rezultatet e vlerësimeve të studentëve për profesorët. Madje, edhe dekanët e fakulteteve tjera që intervistuaam shprehën të njëjtin shqetësim, duke thënë se për këtë përgjegjës është Rektorati i UP-së.
- Për 2 fakultete dekanët theksojnë nevojën e një analize të programeve konform nevojave të tregut, por deri më tani asgjë nuk është bërë në këtë drejtim as nga fakultetet, as nga UP-ja, e madje as nga institucionet relevante shtetërore.

II.

**BIBLIOTEKAT
DHE SALLAT**

II. BIBLIOTEKAT DHE SALLAT

Hyrje

Qëllimi i dytë i këtij publikimi është evidentimi i gjendjes në biblioteka dhe salla të leximit të fakulteteve të UP-së: a) ka secili fakultet bibliotekë dhe sallë të leximit; sa janë të furnizuara bibliotekat; si bëhet regjistrimi i librave; si është gjendja në sallat e leximit; sa ekzemplarë ka në bibliotekën e secilit fakultet; sa është numri i ulëseve në salla të leximit; sa është raporti ulëse-studentë, e me radhë. Për këtë: a) zhvilluam intervista me bibliotekistët e fakulteteve; b) vizituam bibliotekat dhe sallat e leximit për të parë gjendjen në to; dhe c) analizuam raportet e fundit të AKA-së për secilin fakultet. Ndër kufizimet kryesore të këtij hulumtimi ishin: a) mungesa e bibliotekistëve në disa fakultete për shkak të pensionimit të tyre (për këtë kemi kontaktuar zyrtarë të tjerë nëpër këto fakultete); b) pamundësia për të pasë qasje në disa prej bibliotekave; dhe c) mungesa e raporteve të AKA-së për disa prej fakulteteve.

1. Fakulteti i Arteve

Ka dy biblioteka me afro 2 mijë ekzemplarë gjithsej, pjesa më e madhe e të cilave në anglisht e në shqip. Të dy bibliotekat shërbejnë edhe si salla të leximit me rreth 80 ulëse. Dekani Agim Selimi nuk ka të dhëna se sa frekuenohen sallat nga studentët e as se kur është bërë pranimi i fundit i librave, por thotë biblioteka është e furnizuar me literaturë moderne dhe se në të gjenden librat e profesorëve të këtij fakulteti. Në salla ka internet, por nuk ka kompjuterë, printerë, skanerë e as fotokopjues²⁶. Sipas të dhënave të Rektoratit, ky fakultet numëron 935 studentë, që i bie se një vend leximi e ndajnë 11 studentë, e bazuar në numrin e ekzemplarëve, del se në këtë fakultet ka dy ekzemplarë për student. Sipas raportit final të AKAsë, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në qershor 2016, biblioteka nuk mund të krahasohet me bibliotekat e njësisive të ngjashme akademike europiane, të cilat kanë numër të njëjtë të studentëve²⁷. Njëri nga ekspertët e raportit thotë se nuk i është mundësuar vizita në bibliotekën e këtij fakulteti²⁸. Në fakt, ky fakultet nuk ka bibliotekiste që nga viti 2015, ndonëse Dekani Selimi thotë se kanë bërë kërkesë në Rektorat vazhdimisht, mirëpo nuk kanë marrë përgjigje²⁹.

Dekani Agim Selimi:

“Fakulteti i Arteve nuk ka bibliotekiste që nga viti 2015. Kemi bërë kërkesë në Rektorat vazhdimisht, mirëpo nuk kemi marrë përgjigje.

²⁶ Intervistë me Agim Selimin, Dekan i Fakultetit të Arteve, 26 qershor 2018.

²⁷ Fryer, Andrew, et al. «University of Prishtina, Faculty of Fine Arts: External Report: June 2016», faqe 19, Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2016.

²⁸ Po aty, faqe 14.

²⁹ Intervistë me Agim Selimin, Dekan i Fakultetit të Arteve, 26 qershor 2018.

Bibliotekisti Ismet Ajvazi:

“ Sugjeroj që profesorët t’i sjellin librat e tyre autorial në bibliotekë, gjë që nuk ndodhë për shkak se duan të përfitojnë nga shitja e tyre.

-122.000
ekzemplarë

në të gjitha bibliotekat e fakulteteve të UP-së së bashku

48.735
studentë

gjithsejt në UP

2.5
libra për student

2. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Biblioteka ka afro 2 mijë ekzemplarë, shumica e të cilave në anglisht, pastaj në shqip e një pjesë e vogël edhe në gjermanisht. Përgjegjësi i bibliotekës sugjeron që profesorët t’i sjellin librat e tyre autorial në bibliotekë, gjë që nuk ndodhë për shkak se, sipas tij, duan të përfitojnë nga shitja e tyre. Biblioteka është në shërbim të studentëve të këtij fakulteti çdo ditë pune dhe frekuentohet nga afro 10-12 studentë në ditë. Studentët kanë të drejtë t’i nxjerrin librat jashtë në një afat kohor prej dy javësh, kurse për ta vazhduar kohëzgjatjen duhet të lajmërohen sërish në bibliotekë. Biblioteka i regjistron librat në libër të shënimeve ku studentët duhet të tregojnë kartelën e studentit dhe të nënshkruajnë. Pranimi i fundit i librave është bërë para dy vitesh nga një donacion i TEMPUS-it (Trans-European Mobility Programme for University Studies) - rreth 160 ekzemplarë. Ky fakultet ka edhe sallën e leximit me 60 ulëse. Sipas të dhënave të Rektoratit, ky fakultet numëron 1.964 studentë, që i bie se një vend leximi e ndajnë 33 studentë, e bazuar në numrin e ekzemplarëve, në këtë fakultet ka një libër për student. Salla e leximit është e hapur çdo ditë pune. Në të ka internet, por nuk ka kompjuterë, printerë, skanerë e as fotokopjues³⁰. Në raportin final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në maj 2016, thuhet se studentët ankohen për mungesë të teksteve universitare dhe mundësisë së humtimit online³¹.

³⁰ Intervistë me Ismet Ajvazin, bibliotekist në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, 26 qershor 2018.

³¹ Doluschitz, Reiner, Melita dhe kantelhardt, Jochen «Reacriditation Procedure», faqe 5, Agjencia Kosovare e Akreditimit, 11-13 maj 2016.

3. Fakulteti i Edukimit

Dekani i Fakultetit të Edukimit, Ethem Çeku, dhe Sekretari i Fakultetit, Milaim Mazreku, nuk janë përgjigjur në kërkesat tona të vazhdueshme për të zhvilluar intervistë lidhur me gjendjen në bibliotekën e këtij fakulteti. Raporti final i AKA-së, i përpiluar nga ekspertët ndërkombëtarë në qershor 2017, thotë se shqetësim i madh është qasja në bibliotekë dhe në titujt e nevojshëm. Sipas këtij raporti, biblioteka është jofunksionale, ka numër të limituar të titujve dhe mungesë të resurseve njerëzore. Po ashtu, në raport thuhet se biblioteka nuk frekuentohet pothuajse kurrë nga studentët³².

4. Fakulteti i Ekonomisë

Dekani i Fakulteti të Ekonomisë, But Dedaj, nuk është përgjigjur në kërkesën tonë për të zhvilluar intervistë. Po ashtu, përkundër kërkesës tonë për ta vizituar bibliotekën e këtij fakulteti, Sekretarja e Fakultetit, Valbona Zhubi, përmes e-mail-it na ka informuar se nuk ka zyrtar në bibliotekë, meqë është pensionuar³³. Raporti final i AKA-së, i përpiluar nga ekspertët ndërkombëtarë në gusht 2015, thotë se biblioteka e këtij fakulteti është shumë e varfër³⁴.

AKA:

“ Biblioteka është jofunksionale, ka numër të limituar të titujve, mungesë të resurseve njerëzore dhe nuk frekuentohet pothuajse kurrë nga studentët.

“ Sekretarja e Fakultetit, Valbona Zhubi, thotë se nuk ka zyrtar në bibliotekë, meqë është pensionuar. E raporti final i AKA-së thotë se biblioteka e këtij fakulteti është shumë e varfër.

³² Kovacevic, Melita dhe Volker Frederking. «External Evaluation Report», faqe 11, Agjencia Kosovare e Akreditimit, 15 qershor 2017.

³³ Intervistë me e-mail me Valbona Zhubin, Sekretare e Fakultetit të Ekonomisë, 29 qershor 2018.

³⁴ Gehmlich, Volker dhe Cavlek, Nevenka. «Public University Prishtina “Hasan Prishtina, Faculty of Economics, Programme Accreditation Report, August 2015», faqe 29, Agjencia Kosovare e Akreditimit, 2-3 gusht 2015.

AKA:

“ Është shqetësuese mungesa e titujve relevant në bibliotekë dhe kushtet e këqia në bibliotekë e në sallë të leximit. Mungesa e një programi ndërkombëtar të librave dhe revistave shkencore, e edhe literatura irelevante, e bëjnë këtë bibliotekë pothuajse të papërdorshme për studentët.

5. Fakulteti i Filologjisë

Biblioteka ka afro 16.500 ekzemplarë – 1.500 prej të cilave janë fjalorë, kurse të tjerat libra, revista e broshura. Pjesa më e madhe e librave janë në shqip, pastaj në anglisht, turqisht dhe disa në gjermanisht e italisht. Biblioteka shërben edhe si sallë leximi dhe është në shërbim të studentëve të këtij fakulteti çdo ditë pune, frekuentohet nga rreth 100 studentë në ditë dhe ka rreth 70-80 ulëse. Në të nuk ka internet, kompjuterë, printerë, skanerë e as fotokopjues. Sipas të dhënave të Rektoratit, fakulteti numëron 3.379 studentë, që i bie se një vend leximi e ndajnë 45 vetë, e bazuar në numrin e ekzemplarëve, në këtë fakultet ka pesë libra për një student. E pyetur se a gjenden librat e profesorëve të këtij fakulteti në bibliotekë, bibliotekistja tregon se disa i sjellin, e disa jo. Sipas saj, obligim nuk e kanë, por do të duhej që të gjithë t'i sillnin. Biblioteka i regjistron librat së pari me dorë në librat e inventarit, e më pas në Excel sepse mungon programi adekuat për këtë³⁵. Pranimi i fundit i librave është bërë para 2-3 muajve nga Instituti Albanologjik, me ç'rast janë pranuar afro 50 libra. Sipas raportit final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtar në qershor 2016, është shqetësuese mungesa e titujve relevant në bibliotekë dhe kushtet e këqia në bibliotekë e në sallë të leximit. Sipas tyre, mungesa e një programi ndërkombëtar të librave dhe revistave shkencore, e edhe literatura irelevante, e bëjnë këtë bibliotekë pothuajse të papërdorshme për studentët³⁶.

³⁵ Intervistë me Enita Hysenin, bibliotekiste në Fakultetin e Filologjisë, 11 qershor 2018.

³⁶ Asllani, Persida, et al. «University of Prishtina Faculty of Philology Reaccreditation Report June 2016», faqe 4, 26. Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2016.

6. Fakulteti i Filozofisë

Biblioteka ka afro 13 mijë ekzemplarë – libra, revista e broshura – pjesa më e madhe në shqip, e të tjerat në anglisht, sërbo-kroatisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, e me radhë. Biblioteka është në shërbim të studentëve të këtij fakulteti çdo ditë pune, përveç të enjteve, dhe frekuentohet nga afërsisht 50 studentë në ditë. Përgjegjëset e kësaj biblioteke thonë se ajo është mesatarisht e furnizuar dhe shtojnë se studentët ankohen për mungesë të literaturës dhe të botimeve të reja. Ata kanë të drejtë t'i nxjerrin librat për kohë të caktuar, dhe ka raste kur i vonojnë ose nuk i kthejnë, për çka nuk ndëshkohen për mungesë mekanizmesh³⁷. E pyetur se a gjenden librat e profesorëve të këtij fakulteti në bibliotekë, bibliotekistja thotë se pjesa më e madhe i sjellin, por jo të gjithë. Biblioteka i regjistron librat vetëm në Excel, pa ndonjë format të caktuar, pra nuk ka program për të rezervuar libra online. Ky fakultet ka edhe sallën e leximit me 78 tavolina për lexim individual. Salla e leximit është e hapur çdo ditë dhe shfrytëzohet vetëm nga studentët e këtij fakulteti. Në të ka internet, por nuk ka kompjuterë, printerë, skanerë e as fotokopjues³⁸. Sipas të dhënave të Rektoratit, ky fakultet numëron 4.183 studentë, që i bie se një vend leximi e ndajnë 58 studentë, e bazuar në numrin e ekzemplarëve, në këtë fakultet ka tre libra për studentë. Pranimi i fundit i librave është bërë në korrik 2018, me ç'rast janë pranuar 800 ekzemplarë, donacion nga Rektorati i UP-së.

Sipas raportit final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtarë në qershor 2017, gjendja e mjerueshme në bibliotekën e këtij fakulteti vazhdon me qenë shqetësuese: numri i teksteve është i limituar, shumë prej tyre janë të tejkaluara, nuk ka revista të specializuara, literatura bazë që e kërkojnë profesorët nuk gjendet në të. Qa-

AKA:

“Gjendja e mjerueshme në bibliotekën e këtij fakulteti vazhdon me qenë shqetësuese: numri i teksteve është i limituar, shumë prej tyre janë të tejkaluara, nuk ka revista të specializuara, literature bazë që e kërkojnë profesorët nuk gjendet në të.

³⁷ Intervistë me Ardita Beshiri-Durmishi, bibliotekiste në Fakultetin e Filozofisë, 31 maj 2018.

³⁸ Intervistë me Hajrije Pajazitin, bibliotekiste në Fakultetin e Filozofisë, 31 maj 2018.

sja në revistat akademike përmes databazës për e-revista EBSCO është jashtëzakonisht problematike, e kohëve të fundit edhe është ndërprerë. Nuk ka revista elektronike ose hard copy. Kjo situatë krijon implikime serioze për studimet BA, MA dhe PhD. Për më shumë, për shkak të mungesës së buxhetit nuk ka një plan për zhvillimin e bibliotekës, edhe pse për vitin 2018 janë ndarë 9 mijë € për furnizimin me literaturë për gjithë fakultetin³⁹.

7. Fakulteti i Juridikut

Biblioteka ka afro 4 mijë tituj me nga 5 ekzemplarë secilin, pjesa më e madhe në shqip e në anglisht, e edhe në gjermanisht. Biblioteka është në shërbim të studentëve çdo ditë pune. Për dallim prej bibliotekave tjera, këtu pranohen libra shumë shpesh. Bibliotekistja thotë se profesorët janë të obliguar t'i sjellin dhe i sjellin nga 5 kopje të librave të tyre. Librat mund të nxirren jashtë me ID të studentit dhe kohëzgjatja e mbajtjes së librit është një javë. Biblioteka e këtij fakulteti është e pasur me libra që kanë të bëjnë me ligjin dhe përmbanë literaturë shumë specifike të këtij drejtimi. Është e vetmja bibliotekë në UP e cila ka një program specifik për regjistrimin e librave. Programi, i përpunuar nga USAID-i, funksionon në bazë të ALEF 500 dhe mundëson me i pa gjitha të dhënat e librit si: autorin, vitin e botimit, numrin e faqeve, departamentin të cilit i takon, e me radhë⁴⁰. Salla e leximit ka 98 tavolina për lexim individual. Sipas të dhënave të Rektoratit, Fakulteti i Juridikut, bashkë me Fakultetin e Ekonomisë numërojnë 17.834 studentë (meqë ndajnë të njëjtën hapësirë) dhe kanë bibliotekat dhe sallat e ndara, andaj është vështirë të dihet raporti studentë-sallë leximi. Përgjegjëset e kësaj biblioteke thonë se studentët e këtij

AKA:

“ Biblioteka e këtij fakulteti është e pasur me libra që kanë të bëjnë me ligjin dhe përmbanë literaturë shumë specifike të këtij drejtimi. Është e vetmja bibliotekë në UP e cila ka një program specifik për regjistrimin e librave.

³⁹ Adam, Stephen dhe Vjekoslav Afric. «KAA SITE VISIT: Faculty of Philosophy (University of Pristina), 1-2 June 2017», faqe 3–9, Agjencia Kosovare e Akreditimit, 15 qershor 2017.

⁴⁰ Intervistë me Faze Sadikaj, bibliotekiste në Fakultetin Juridik, 22 qershor 2018.

fakulteti ankohen për mungesë të vendeve në sallë të leximit⁴¹. Në të ka internet, por nuk ka kompjuterë, skaner, printer e fotokopjues. Sipas raportit final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtar në maj 2017, duhet të punohet në zgjerimin dhe rregullimin e sallës së leximit si dhe në azhurnimin e bibliotekës me tituj e dokumente në të gjitha fushat në mënyrë që të përmbushen standardet ndërkombëtare⁴². Në raport theksohet nevoja për një bibliotekë të specializuar për nivelin master.

Fakulteti Juridik ka edhe Qendrën për të Drejtat e Njeriut dhe Qendrën për Barazi Gjinore, që kanë një bibliotekë të përbashkët, në shërbim të studentëve të UP-së, me afro 3 mijë ekzemplarë, me rreth $\frac{3}{4}$ në anglisht, e të tjerat në shqip⁴³.

8. Fakulteti i Mjekësisë

Biblioteka ka rreth 48 mijë ekzemplarë të të gjitha lëmive. Librat janë në shqip, anglisht, sërbo-kroatisht, e disa edhe në rusisht. Biblioteka është mirë e furnizuar dhe frekuentohet nga rreth 30 studentë në ditë. Është në shërbim të studentëve dhe stafit të këtij fakulteti çdo ditë pune. Studentët mund t'i shfrytëzojnë librat për një periudhë kohore prej një muaj, e pas kësaj kohe duhet të lajmërohen në bibliotekë për ta vazhduar kohëzgjatjen e mbajtjes së librit⁴⁴. E pyetur se a gjenden librat e profesorëve të këtij fakulteti në bibliotekë, bibliotekistja thotë se pjesa më e madhe nuk i sjellin. Biblioteka i regjistron librat në mënyrë klasike, në librin amë dhe me kartona, kurse nuk

⁴¹ Intervistë me Lumnije Gashin, bibliotekiste në Fakultetin Juridik, 22 qershor 2018.

⁴² Falterbaum, Johannes. «Final Report Program Reaccreditation Procedure at University of Prishtina Faculty of Law», faqe 26–35, Agjencia Kosovare e Akreditimit, maj 2017.

⁴³ Intervistë me Vjollca Maxherrën, zyrtare për financa në Qendrën për të Drejtat e Njeriut, 17 korrik 2018.

⁴⁴ Intervistë me Hilmije Cakollin, bibliotekiste në Fakultetin e Mjekësisë, 8 korrik 2018.

AKA:

“ Fakulteti gjithashtu ka bibliotekën elektronike e cila gjendet në Qendrën e Telemjekësisë, ku stafi akademik ka qasje në një numër të madh të revistave akademike online.

ka një program adekuat për këtë, e madje as dy kompjuterët që janë në shërbim të bibliotekistëve nuk punojnë, kurse pranimi i librave për herë të fundit është bërë në qershor-korrik 2018, me ç'rast janë pranuar 14 tituj nga 300 ekzemplarë, gjithsejt 4200 ekzemplarë, nga MASHT-i në bashkëpunim me UP-në⁴⁵. Fakulteti gjithashtu ka bibliotekën elektronike e cila gjendet në Qendrën e Telemjekësisë, ku stafi akademik ka qasje në një numër të madh të revistave akademike online⁴⁶. Fakulteti i Mjekësisë ka edhe katër salla leximi të cilat janë të hapura çdo ditë pune, e të cilat frekuentohen edhe nga studentët të fakulteteve tjera, sidomos nga ato teknike. Numri total i ulëseve në salla është 410, por studentët gjatë pushimeve semestrale kanë në dispozicion edhe amfiteatrin e ORL-së, i cili ka 180 vende studimi. Sipas të dhënave të Rektoratit, ky fakultet numëron 4.244 studentë, pa llogatitë sallën e ORL-së, që i bie se një ulëse e ndajnë 10 studentë, e bazuar në numrin e ekzemplarëve, në këtë fakultet ka 11 libra për studentë. Përgjegjësja e bibliotekës tregon se studentët kanë ankesa për kushtet në sallat e leximit, me theks të veçantë për papastërtinë. Sallat e leximit nuk kanë kompjuterë, printerë, skanerë, fotokopjues, e as internet. Sipas raportit final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtar në qershor 2017, gjendja infrastrukturore në këtë fakultet është përgjithësisht e mirë. Ka hapërisa të mjaftueshme për mësimdhënie teorike, si për nga sallat ashtu edhe për nga laboratoritë e kompjuterëve dhe biblioteka. Gjithashtu, ka databaza me artikuj dhe libra, gjë për të cilën studentët janë shprehur të kënaqur⁴⁷.

⁴⁵ Intervistë përmes telefonit me Saranda Shaqirin, bibliotekiste në Fakultetin e Mjekësisë, 14 shtator 2018.

⁴⁶ Intervistë me e-mail me Gloria Staka, Prodekane për çështje financiare në Fakultetin e Mjekësisë, 27 qershor 2018.

⁴⁷ Zeleznik, Danica dhe Helvi Kyngës. «Reaccreditation of Study Programs of the Faculty of Medicine at the University of Prishtina 'Hasan Prishtina'», faqe 6, Agjencia Kosovare e Akreditimit, qershor 2017.

9. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit

Biblioteka ka afro 600 ekzemplarë, pjesa më e madhe e të cilave janë në shqip, pastaj në anglisht e në serbo-kroatisht. Është në shërbim të studentëve të këtij fakulteti çdo ditë pune, por nuk ka të dhëna se sa frekuentohet nga studentët. Biblioteka i regjistron librat në Excel dhe studentët mund t'i nxjerrin librat për kohë të caktuar, jo më gjatë se një muaj, me kartelën e studentit. Librat më të kërkuar nga studentët janë në shqip, kurse nga profesorët kryesisht në anglisht. Pranimi i fundit i librave është bërë në fillim të vitit 2018, me ç'rast janë pranuar 40 ekzemplarë në anglisht. E pyetur se a gjenden librat e profesorëve të këtij fakulteti në bibliotekë, bibliotekistja thotë se disa janë. Biblioteka shërben si sallë leximi dhe ka vend për 12 persona⁴⁸. Sipas të dhënave të Rektoratit, ky fakultet numëron 785 studentë, që i bie se një vend leximi e ndajnë 65 studentë, e bazuar në numrin e ekzemplarëve, në këtë fakultet ka një libër për studentë. Salla është e pajisur me internet dhe ka një kompjuter e një printer. Në raportet e viteve të fundit të AKA-së nuk përmenden askund biblioteka dhe salla e këtij fakulteti.



Asnjë nga bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë kompjuterë, printer, skaner e as fotokopjues.

10. Fakultetet Teknike (FNA, FIEK, FIM)

Biblioteka e përbashkët e këtyre tri fakulteteve ka afro 7 mijë ekzemplarë, pjesa më e madhe e të cilave në anglisht, pastaj në shqip dhe në serbisht. Është në shërbim të studentëve të këtij fakulteti çdo ditë pune, por nuk ka të dhëna se sa studentë e frekuentojnë. Pranimi i fundit i librave është bërë në qershor të vitit 2018, me ç'rast janë pranuar 5 tituj me nga 100 ekzemplarë secili, donacion nga Biblioteka Universitare në bashkëpunim me Rektoratin e UP-së. Përgjegjësja e kësaj biblioteke thotë se studentët ankohen për mungesë të literaturës, kurse



Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti i Mjeksësisë dhe Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, nuk kanë as internet.

⁴⁸ Intervistë me Florie Ismailin, bibliotekiste në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, 25 qershor 2018.

“ Edhe pse problemi i bibliotekës është përmendur në disa raporte të mëparshme, përmirësimet janë të ngadalta dhe mund ta penalizojnë akreditimin e programeve MA në të ardhmen. Gjithashtu, pa ndërhyrje të dukshme në këtë drejtim nuk do të lejohet asnjë program PhD.

shton se biblioteka duhet rinovuar meqë është vjetruar dhe si e tillë nuk i plotëson kushtet. E pyetur se a gjenden librat e profesorëve të këtij fakulteti në bibliotekë, bibliotekistja thotë se disa i sjellin e disa jo. Studentët duhet të kenë ID kartelën për të marrë libra dhe gjitha të dhënat regjistrohen vetëm në Excel⁴⁹. Fakultetet teknike kanë edhe sallën e leximit e cila ka ndarje të shumta dhe tavolina për lexim individual. Salla e leximit është e hapur çdo ditë pune dhe ka 186 ulëse⁵⁰. Sipas të dhënave të Rektoratit, ky fakultet numëron 6.648 studentë, që i bie se një vend leximi e ndajnë 36 studentë, e bazuar në numrin e ekzemplarëve, në këtë fakultet ka një libër për student. Në të ka internet, por nuk ka kompjuterë, printerë, skanerë e as fotokopjues. Sipas raportit final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtar në qershor 2017, biblioteka (e arkitekturës) nuk i përmbushë standardet evropiane. Salla e leximit është e vogël, gjë për të cilën edhe studentët kanë ankesa. Edhe pse problemi i bibliotekës është përmendur në disa raporte të mëparshme, përmirësimet janë të ngadalta dhe mund ta penalizojnë akreditimin e programeve MA në të ardhmen. Gjithashtu, në raport thuhet se pa ndërhyrje të dukshme në këtë drejtim nuk do të lejohet asnjë program PhD. Meqë ka mungesë buxheti dhe pak profesorë që publikojnë libra, rekomandohet që secili profesor të sjellë në bibliotekë të paktën disa kopje të teksteve të botuara⁵¹.

⁴⁹ Intervistë me Merita Gllarevën, bibliotekiste në Fakultetet Teknike, 25 qershor 2018.

⁵⁰ Intervistë me e-mail me Abdullah Zejnullahun, Dekan i Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, 4 qershor 2018.

⁵¹ Dombay, Gábor dhe Jaroslav Kruis. «Report of the expert team on re-accreditation procedure of master programs at Faculty of Civil Engineering and Architecture, University of Prishtina», Agjencia Kosovare e Akreditimit, faqe 4, 5 qershor 2016.

11. Fakulteti i Shkencave Matematikë-Natyrore

Ka 4 biblioteka: kimi, matematikë, fizikë dhe gjeografi. Pjesa më e madhe e librave janë në shqip, pastaj në anglisht, rusisht dhe disa në sërbo-kroatisht. Pranimi i fundit i librave është bërë në korrik të vitit 2018, me ç'rast është pranuar një kontigjent prej 2300 ekzemplarëve nga Biblioteka Universitare. Bibliotekat shërbejnë edhe si salla leximi për studentët e këtij fakulteti, kurse nuk ka të dhëna për numrin e studentëve që i frekuentojnë ato. Studentët marrin librat me kartelën e studentit dhe mund t'i shfrytëzojnë ato vetëm në salla të leximit⁵². I pyetur se a gjenden librat e profesorëve të këtij fakulteti në bibliotekë, prodekani Agim Gashi thotë se librat e profesorëve gjenden në bibliotekat e gjeografisë, matematikës dhe kimisë. Sallat e departamenteve të FShMN-së kanë gjithsejt afërsisht 200 ulëse, e sipas të dhënave të Rektoratit, FShMN-ja ka 3.829 studentë, që i bie se një vend leximi e ndajnë afërsisht 19 studentë. Ndërkaq, në total janë rreth 13 mijë ekzemplarë, që do të thotë në këtë fakultet ka 3 libra për student. Bibliotekat nuk kanë internet, kompjuterë, printerë, skanerë, e as fotokopjues. Sipas raportit final të AKA-së, të përpiluar nga ekspertë ndërkombëtar në maj 2017, infrastruktura aktuale është e tmerrshme, mobilet janë të stërvjetruara, klasat e shëmtuara dhe xhamat e thyer⁵³.

“ Bibliotekat e FShMN-së nuk kanë internet, kompjuterë, printerë, skanerë, e as fotokopjues. E sipas AKA-së, infrastruktura aktuale është e tmerrshme, mobilet janë të stërvjetruara, klasat e shëmtuara dhe xhamat e thyer.

⁵² Intervistë me Agim Gashin, Prodekan i Fakultetit të FShMN-së, 3 korrik 2018.

⁵³ Normak, Peeter dhe Mladen Krajacic. «Accreditation Report External Expert Team Faculty of Mathematics and Natural Sciences University of Prishtina», Agjencia Kosovare e Akreditimit, faqe 14, 23 maj 2017.

Përfundime

- Bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk janë të furnizuara me literaturë bashkëkohore: nuk ka literaturë adekuate për drejtimet specifike të fakulteteve përkatëse dhe nuk ka qasje në databaza ndërkombëtare shkencore. Madje, edhe pse UP-ja ka qasje në revistat e ELSEVIER-it, bibliotekat e fakulteteve dhe studentët nuk mund të qasen në këto revista.
- Të gjitha bibliotekat e fakulteteve të UP-së së bashku kanë afro 122 mijë ekzemplarë, e sipas të dhënave të Rektoratit, UP-ja ka gjithsejt 48.735 studentë, që i bie se bibliotekat e fakulteteve të UP-së kanë 2.5 libra për student. Për nga numri i librave për student prinë Mjekësia me 10, pastaj Filologjia me 5 dhe Filozofia e FShMN-ja me nga 3.
- Të gjitha sallat e fakulteteve të UP-së së bashku, duke përfshirë Fakultetin e Edukimit dhe të Ekonomisë, kanë afro 1.200 ulëse, e sipas të dhënave të Rektoratit, UP-ja ka gjithsejt 48.735 studentë, që i bie se sallat e fakulteteve të UP-së kanë afërsisht 1 ulëse për 50 studentë.
- Asnjë nga bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë kompjuterë, printer, skaner e as fotokopjues, madje disa prej tyre, si: Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti i Mjekësisë dhe Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, nuk kanë as internet.

- Bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë resurse të mjaftueshme njerëzore, madje Fakulteti i Arteve, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Edukimit nuk kanë as bibliotekistë, e për rrjedhojë ato edhe janë të mbyllura.
 - Bibliotekat e fakulteteve të UP-së i regjistrojnë librat në Excel ose në librin amë, mënyra këto të tejkaluara tashmë, që do të thotë se nuk kanë një program specifik online për regjistrimin e librave (me përjashtim të Fakultetit Juridik që e ka një program, por jo të plotë), i cili do t'ua lehtësonte punën jo veç bibliotekistëve, por edhe studentëve, duke u mundësuar të rezervojnë libra online e ta zgjasin kohën e lejuar të huazimit, e me radhë.
 - Asnjë nga bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë libra online.
-

III.

REVISTAT

AKADEMIKE

III. REVISTAT AKADEMIKE

Hyrje


Qëllimi i tretë dhe i fundit i këtij publikimi ishte për të parë se a kanë 13 fakultetet e UP-së (me 41 departamente gjithsejt) revista ku publikohen punimet eventuale të stafit? Nëse nuk kanë, pse nuk kanë? Nëse kanë, a janë të qasshme për gjithë komunitetin në çdo kohë, a kanë ISSN, a kanë ‘peer review’ dhe a janë të indeksuara në databaza serioze? Të gjitha këto kriterë shërbejnë për t’u siguruar se revista i përmbushë standardet teknike dhe cilësore të një reviste serioze.

Qasja në revista zakonisht sigurohet përmes indeksimit të tyre në databaza serioze. Kriteri i domosdoshëm teknik për indeksimin në databaza serioze është që revistat të kenë ISSN, kod i njohur ndërkombëtarisht që identifikon publikimet serike. Pra, ISSN-ja nuk është kriter profesional, por vetëm kriter teknik⁵⁴. Për t’u indeksuar në databaza serioze (SCOPUS, WOS, etj.) është e domosdoshme që revistat ta praktikojnë procesin ‘peer review’.

Meqë përmes procesit të shqyrtimit bëhet përpjekje për t’u siguruar se artikujt i përmbushin standardet e cilësisë së revistës dhe të vlefshmërisë shkencore, është e rëndësishme të sqarohen hapat e këtij procesi. Fillimisht, redaktori i revistës vlerëson se a janë përmbushur kriteret nga autori i artikullit. Nëse po, atëherë i fton ekspertët e lëmisë për ta shqyrtuar (zakonisht dy ose tre ekspertë). Më pas, ekspertët përpilojnë një raport me kritik, sugjerime, vërejtje, e me radhë, për artikullin, që redakto-

54 “What Is an ISSN?” *International Identifiers for Serials and Other Continuing Resources, in the Electronic and Print World*, International Serial Standard Number International Centre, www.issn.org/understanding-the-issn/what-is-an-issn/.

ri ia kthen autorit për përmirësim. Pas inkorporimit të sugjerimeve, autori ia dorëzon edhe një herë artikullin për vlerësim redaktorit. Ky i fundit merr dhe një herë mendimet e ekspertëve dhe pastaj vendosë nëse artikulli ka përmbushur të gjitha standardet (teknike e shkencore) për publikim. Pra, në artikujt e revistave që e praktikojnë procesin e shqyrtimit ose ‘peer review’, figuron emri i redaktorit që ka përcjellur procesin. Shih figurën të ilustruar nga Elsevier.⁵⁵



⁵⁵ Elsevier. “What Is Peer Review?” 10th Edition, Mosby, www.elsevier.com/reviewers/what-is-peer-review.

“ Fakulteti i Arteve nuk ka pasë ndonjëherë revistë të vetën. Megjithatë, dy profesorë të këtij fakulteti, Fadil Hysaj dhe Bekim Lumi, kanë nxjerrë vet nga një revistë.

“ Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë në të kaluarën kishte dy revista, e sot asnjë.

1. Fakulteti i Arteve

Fakulteti i Arteve nuk ka pasë e nuk ka as tani revistë të vetën. Megjithatë, dy profesorë të këtij fakulteti, Fadil Hysaj dhe Bekim Lumi, kanë nxjerrë vet nga një revistë: profesor Hysaj ka nxjerrë revistën «Theatri» nga viti 1995 deri në vitin 2000 (gjithsej 6 numra)⁵⁶, ndërsa profesor Lumi ka nxjerrë revistën «Loja» nga viti 2007 deri në vitin 2011 (gjithsej 6 numra). Ky fakultet, me tre departamente (artet figurative, artet dramatike dhe artet muzikore) nuk e nxjerrë asnjë revistë.

2. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë kishte dy revista: «Bioteknika» dhe «Bioteknologjia» me punime nga lëmia e bujqësisë dhe veterinarisë. «Bioteknika», numri i parë i së cilës doli më 1978, botohej çdo tre muaj nga «Lidhja e Inxhinjerëve dhe Teknikëve Bujqësorë të KSA të Kosovës». Në të botonin autorë vendorë e të huaj, në shqip dhe në sërbiisht, të shoqëruara me nga një përmblidhje në anglisht. Revista kishte ISSN dhe këshill redaktues profesional. Ndërkaq, për revistën «Bioteknologjia» nuk kishte të dhëna askush në dekanatin e këtij fakulteti. Aktualisht, ky fakultet, me gjashtë departamente (agroe-konomi, bioteknologji në zootekni, lavërtari-perimtari, mbrojtja e bimëve, pemëtari-vreshtari dhe veterinari) nuk e ka asnjë revistë.

⁵⁶ Intervistë përmes Facebook me Fadil Hysaj, Profesor në Fakultetin e Arteve, 4 shtator 2018.

3. Fakulteti i Edukimit

Fakulteti i Edukimit kishte revistën «Educologia», e cila kishte përmbajtje të natyrës dhe edukative. Numri i parë i revistës ka dalë më 2002 e i fundit më 2012. Gjithsej u botuan 5 numra. Punimet në këtë revistë botoheshin në shqip dhe anglisht, e disa edhe në turqisht e boshnjakisht, kurse autorët ishin shqiptarë e të huaj. Revista përgatitej vullnetarisht nga një pjesë e stafit, kurse botohej nga Rektorati i UP-së⁵⁷. Fakulteti i Edukimit, me dymbëdhjetë programe, tani nuk nxjerrë asnjë revistë.

4. Fakulteti i Ekonomisë

Fakulteti i Ekonomisë kishte revistën «Economia», numri i parë i së cilës doli më 1973, e i fundit më 1989 (gjithsej afro 60 numra). Në të publikoheshin punimet e autorëve vendorë e ndërkombëtarë, në gjuhën shqipe e kroate dhe shoqëroheshin me rezume në anglisht. Revista kishte ISSN dhe ‘peer review’⁵⁸. Aktualisht, Fakulteti i Ekonomisë ka revistën «Balkan Economic Review», numri i parë i së cilës ka dalë më 2017, si përmbledhje e punimeve më të mira të konferencës ndërkombëtare “Shoqëria e Bazuar në Dije si Strategji për Rritje të Shpejtë Ekonomike”. Revista ka ‘peer review’, kurse në qershor të 2018 mori edhe ISSN. Kryeredaktor i revistës është But Dedaj, ka bord ndërkombëtar dhe botohet edhe në print (<https://www.balkaneconomicreview.net>)⁵⁹.

“ Fakulteti i Ekonomisë kishte revistën «Economia», e cila kishte ISSN dhe ‘peer review’. E sot ka revistën «Balkan Economic Review», numri i parë i së cilës ka dalë më 2017.

⁵⁷ Intervistë me e-mail me Begzad Baliun, Profesor në Fakultetin e Edukimit, 6 shtator 2018.

⁵⁸ Intervistë me Selman Selmanaj, profesor në Fakultetin Ekonomik, 19 qershor 2018.

⁵⁹ Intervistë me Besnik Krasniqin, profesor në Fakultetin Ekonomik, 18 qershor 2018.

Fakulteti i Filologjisë ka dy revista: «Filologji» me gjithsejt 22 numra dhe «Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare» me 36 numra të publikuar deri më sot.

5. Fakulteti i Filologjisë

Fakulteti i Filologjisë ka dy revista: «Filologji» dhe «Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare». Numri i parë i «Filologji»-së doli më 1996, kurse i fundit në vitin 2018 (gjithsejt 22 numra). Kryeredaktor i revistës është Zejnullah Rrahmani, botohet me mbështetje financiare nga UP-ja dhe përmban studime, trajtesa e artikuj nga albanologë shqiptarë e edhe të huaj. Pjesa më e madhe e artikujve janë në shqip, e ndonjë në anglisht e në frëngjisht. Kjo revistë nuk ka ISSN, meqë Kosova nuk është anëtare e OKB-së⁶⁰. Ndërsa, «Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare» ka dalë për herë të parë më 1975, e i fundit më 2017. Deri më sot janë publikuar 36 numra gjithsejt. Rrahman Paçarizi është kryeredaktor i revistës, e cila financohet herë nga buxheti i fakultetit, e herë nga MKRS (Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit)⁶¹. Në të publikohen punimet e seminarit. Në vitin 2017, nëpërmjet Tiranës, ka marrë zyrtarisht ISSN⁶². Dekanja e Fakultetit, Lindita Rugova, pretendon se të dy revistat kanë ‘peer review’ ndërkombëtare⁶³. Online është vetëm një numër i revistës «Filologji» (<https://www.ceeol.com/search/journal-detail?id=2262>), kurse të gjithë numrat e «Revistës së Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare» janë në faqen e fakultetit (<https://filologjia.uni-pr.edu/Seminari.aspx>), e një numër i kësaj reviste është edhe në CEOL (<https://www.ceeol.com/search/journal-detail?id=2261>).

⁶⁰ Intervistë me Abdulla Rexhepin, profesor në Fakultetin Filologjik, 12 qershor 2018.

⁶¹ Intervistë me e-mail me Lindita Sejdiu-Rugova, Dekane e Fakultetit Filologjik, 6 shtator 2018.

⁶² Zëri. “Revista Kosovare Me Numër ISSN.” *Zëri, Zëri*, 13 shtator 2017, zeri.info/kultura/161872/revista-kosovare-me-numer-issn/.

⁶³ Intervistë me e-mail me Lindita Sejdiu-Rugova, Dekane e Fakultetit Filologjik, 11 shtator 2018.

Duhet theksuar se profesorët e Departamentit të Orientalistikës nga viti 2001 e deri më 2012 kishin nxjerrë tre numra të revistës «Studime Orientale», e cila përmbante artikuj nga autorë shqiptarë, por edhe të huaj, në gjuhë shqipe dhe ndonjë recension në arabisht. Drejtuesit e kësaj reviste thonë se do të vazhdojnë me ribotimin e saj⁶⁴. Po ashtu, Departamenti i Gazetarisë nga viti 2009 e deri më 2012 kishte nxjerrë katër numra të revistës «Medie», e cila përmbante studime, artikuj, parashtresa, e me radhë, kryesisht nga fusha e gazetarisë, me autorë vendorë e të huaj. Revistat janë ndërprerë kryesisht për mungesë të financave. Duhet thënë edhe se asnjëra prej tyre nuk kishte ISSN.⁶⁵

Fakulteti i Filologjisë, me dhjetë departamente (gjuhë shqipe, letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi angleze, gjuhë dhe letërsi gjermane, gjuhë dhe letërsi frënge, orientalistikë, gjuhë dhe letërsi turke dhe gazetari) nxjerrë dy revista. Fakulteti i Filologjisë nuk parapaguhet në revista ndërkombëtare, por Dekanja Lindita Rugova thotë se një gjë e tillë bëhet nga Zyra për Kërkime në Rektoratin e UP-së.

6. Fakulteti i Filozofisë

Fakulteti Filozofik kishte dy revista: «Buletini i Fakultetit Filozofik» dhe «Njohja». Numri i parë i «Buletini»-t doli më 1963 e i fundit më 2014 (gjithsej 29 numra), me kryeredaktor Muhamet Malën. Deri në vitin 1990 «Buletini i Fakultetit Filozofik» ishte në dy gjuhë (shqip e sërbo-kroatisht), kurse prej vitit 1990 e deri më 2014 vetëm në shqip. Revista mbështetj financiarisht nga UP-ja. Botimi i mëtejme u ndërpre kryesisht për shkaqe financiare. Ndërkaq, numri i parë i revistës «Njohja», me mbështetj

⁶⁴ Intervistë me Abdulla Rexhepin, profesor në Fakultetin Filologjik, 12 qershor 2018.

⁶⁵ Intervistë me e-mail me Lindita Sejdiu-Rugova, Dekane e Fakultetit Filologjik, 6 shtator 2018.

Nga gjithsejt:

13
fakultete

41
departamente

aktualisht botohen:

5
revista

në

4
fakultete

Fakulteti Filozofik kishte dy revista: «Buletini i Fakultetit Filozofik» dhe «Njohja», mirëpo arsyet kryesore që këto dy revista nuk botohen më janë mungesa e financave dhe demotivimi i stafit për të botuar në to, meqë nuk u njihen për avancim.

financiare nga Ambasada Amerikane në Prishtinë⁶⁶, doli më 2012 e i fundit më 2014. Gjithsej u botuan 3 numra, vetëm në gjuhën shqipe, e me autorë shqiptarë e të huaj. Botimi i kësaj reviste u ndërpre meqë, përveç mungesës së mjeteve financiare, punimet e pjesëtarëve të këtij stafi nuk pranoheshin më për avancime. Pra, arsyet kryesore që këto dy revista nuk botohen më janë mungesa e financave dhe demotivimi i stafit për të botuar në to, meqë nuk u njihen për avancim. Kryeredaktorja e revistës «Njohja», Hasnije Ilazi, thotë se këto revista nuk kishin ISSN, meqë Kosova nuk është anëtare e OKB-së, kurse «Njohja» kishte 'peer review' nga ekspertë ndërkombëtarë dhe vendorë⁶⁷. Që nga vitit 2014, Fakulteti i Filozofisë, me shtatë departamente (filozofi, histori, shkenca politike, sociologji, psikologji, antropologji dhe punë sociale) nuk e nxjerrë asnjë revistë. Po ashtu, ky fakultet nuk parapaguhet në revista ndërkombëtare⁶⁸. Dekani, dr. Bujar Dugolli, nuk pranoi të intervistohet.

⁶⁶ Intervistë me e-mail me Vjollca Krasniqin, Profesoreshë në Fakultetin Filozofik, 10 shtator 2018.

⁶⁷ Intervistë me e-mail me Hasnije Ilazin, Kryeredaktore e revistës 'Njohja', 12 shtator 2018.

⁶⁸ Intervistë me Arben Hajrullahun, profesor në Fakultetin Filozofik, 30 maj 2018; Intervistë me Dashmir Bërxullin, profesor në Fakultetin Filozofik, 5 qershor 2018.

7. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës kishte revistën «Buletini i Punimeve të Fakultetit». Numri i parë doli më 1994 e i fundit më 1998. Gjithsej u botuan 3 numra, në gjuhën shqipe, e me autorë shqiptarë. Përbante punime nga lëmia e inxhinierisë së ndërtimit, por nuk kishte ISSN⁶⁹. Revista financohej nga fakulteti, e ndonjëherë kontribonte edhe ndonjë kompani private. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, me dy departamente e nëntë programe, nuk nxjerrë asnjë revistë⁷⁰.

8. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike ka revistën «Buletini i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike» i cili botohet në mënyrë periodike, kryesisht me rastin e shënimit të përvjetorëve të fakultetit. Numri i fundit është botuar në vitin 2011. Kryetar i këshillit redaktues të revistës, Enver Hamiti, thotë se në të kanë publikuar vetëm autorë shqiptarë, në shqip e me abstrakte në anglisht. Revista nuk kishte ISSN por kishte ‘peer review’, kurse financohej nga UP-ja. Arsyeja kryesore që kjo revistë nuk del më është qasja e stafit për tu orientuar në revista ndërkombëtare⁷¹. Revista nuk gjendet online.

Nga gjithsejt:

5

revista

vetëm

2

janë me
ISSN



⁶⁹ Intervistë me Abdullah Zejnullahun, Dekan në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, 7 shtator 2018.

⁷⁰ Intervistë me Violeta Nushin, profesoreshë në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, 7 shtator 2018.

⁷¹ Intervistë me Enver Hamiti, Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, 20 shtator 2018.

9. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike kishte revistën «Makineria», e cila botonte punime në shqip, të shoqëruara me përmbledhje në anglisht. Numri i parë i revistës ka dalë më 1997 e i fundit më 2002. Revista financohej nga Këshilli Qëndror për Financim i Kosovë në Prishtinë si dhe nga vet stafi i fakultetit, e gjithsej janë botuar 5 numra. Revista nuk kishte ISSN, por kishte këshill redaktues-recenzues të brendshëm. Arsyet e ndërprerjes së botimit ishin kryesisht mungesa e fondeve, vështirësitë për të siguruar ISSN-në, e me radhë. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, me katër departamente (prodhimtari dhe automatizëm, termoenergjetikë dhe termoteknikë, konstruktiv dhe dizajnim si dhe komunikacion) nuk e nxjerrë asnjë revistë⁷².

10. Fakulteti Juridik

Fakulteti Juridik ka revistën «E Drejta», e cila trajton çështje juridike dhe shoqërore. Numri i parë i revistës ka dalë në vitin 1976, i fundit më 2017, kurse numri i radhës është i gatshëm për publikim dhe pritët të botohet së shpejti⁷³. Kryeredaktor i revistës është Qerim Qerimi dhe punimet në këtë revistë botohen në shqip, të shoqëruara me nga një përmbledhje prej një faqe në anglisht. «E Drejta» është revistë periodike dhe publikohen katër numra brenda vitit, varësisht nga numri i artikujve. Financohet nga nga fondet e UP-së, të cilat janë të pamjaftueshme për të pasë staf të përhershëm, website, dhe për të mbuluar shpenzimet tjera që do ndihmonin në rritjen e cilësisë. Revista nuk ka ISSN, por ka peer review⁷⁴. Fakulte-

“ Fakulteti Juridik ka revistën «E Drejta», tre numra të së cilës gjenden online në faqen e fakultetit.

⁷² Intervistë me e-mail me Ahmet Shalën, Dekan në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, 20 gusht 2018.

⁷³ Intervistë përmes Facebook me Qerkin Berishën, profesor në Fakultetin Juridik, 12 shtator 2018.

⁷⁴ Intervistë përmes Facebook me Qerkin Berishën, profesor në Fakultetin Juridik, 12 shtator 2018.

ti Juridik, me tetë departamente (juridik-përgjithshëm, penal-master, civil-master, civil-master-wus, ndërkom-bëtare-master-wus dhe administrativ-kushtetues-master) nxjerrë vetëm një revistë. Vetëm tre numra të revistë janë online në faqen e Fakultetit Juridik (<https://juridiku.uni-pr.edu/Revista--E-Drejta-/Revista-e-Drejta.aspx>)⁷⁵.

11. Fakulteti i Mjekësisë

Fakulteti i Mjekësisë nuk ka pasë e nuk ka as tani revistë të vetën. Duhet thënë se revista në të cilën publikonin punimet e veta stafi i këtij fakulteti, botohej nga Shoqata e Mjekëve të Kosovës dhe quhej «Praxis Medica». Fakulteti i Mjekësisë posedon laboratore ku bëhen hulumtime. Në laboratorin e Biomjekësisë Eksperimentale të Fakultetit të Mjekësisë kryhen hulumtimet në shtazë eksperimentale, kurse në labororet e Anatomisë Patologjike, Mikrobiologjisë, Higjienës si dhe në Klinikat e QKUK-së dhe kryhen hulumtime klinike⁷⁶. Fakulteti i Mjekësisë, me gjashtë departamente (mjekësi e përgjithshme, stomatologji, farmaci, fizioterapi, mami dhe infermieri) nuk e nxjerrë asnjë revistë.

12. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit

Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit kishte revistën «Acta Kinesiologica». Revista është financuar nga vet fakulteti, me financa vetanake, dhe është botuar për rreth 15 vite. Në të publikoheshin punimet e autorëve shqiptarë, me rezume në anglisht. Revista u shua në vitin 2009 për arsye të ndryshme, duke filluar nga mos interesimi për publikim në një revistë vendore, meqë punimet e pjesëtarëve të këtij stafi nuk pranoheshin më për

⁷⁵ Intervistë me e-mail me Qerim Qerimin, profesor në Fakultetin Juridik, 22 gusht 2018.

⁷⁶ Intervistë me e-mail me Gloria Staka, prodekane në Fakultetin e Mjekësisë, 5 shtator 2018.

Nga gjithsejt:

5
revista

vetëm

2

i kanë të gjitha numrat të gashëm online



avancime , mungesa e fondeve, si dhe vullneti i mangët i stafit për të kontribuar me publikime në këtë revistë. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit nuk e nxjerrë asnjë revistë⁷⁷.

13. Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore

Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore (FShMN) ka vetëm revistën «Kërkime Gjeografike» që e nxjerrë Departamenti i Gjeografisë, që nga viti 1979. Deri më 1991 janë publikuar 12 numra, e nga viti 1992 deri më 2004 revista është ndërprerë komplet për shkak të rrethanave gjatë viteve '90, si dhe vështirësive financiare, kurse nga 2004 e tutje, me mbështetje financiare nga UP-ja, vazhdoi publikimi, por jo i rregullt. Gjithsej deri tani janë botuar 18 numra, kurse numri i fundit doli më 2016⁷⁸. Autorët e artikujve në këtë revistë janë shqiptarë dhe ndonjë i huaj, kurse punimet botohen në shqip, me abstrakte në anglisht, ndërsa në të kaluarën artikujt botoheshin në shqip e në serbokroatisht. Kjo revistë ka vetëm ISBN nga Biblioteka e Kosovës - ISBN-ja (International Standard Book Number) është numër identifikues ndërkombëtar që identifikon regjistruerin, titullin, edicionin dhe formatin. Revista nuk ka ISSN dhe as 'peer review'⁷⁹. Gjithash-tu, vetëm një numër i revistës gjendeët online (https://fxm.uni-pr.edu/getattachment/Kerkime-Shkencore/Revista-Shkencore/KERKIME_GJEOGRAFIKE_15_FINALE_B5-1-.pdf.aspx).

Më parë, departamente të ndryshme të FShMN-së kishin revistat e tyre. Ta zëmë, Departamenti i Matematikës kishte revistën «Punime Matematike», që nga viti 1987, me kryeredaktor Eshref Ademaj, e deri më 1996. Kjo

“Përgjegjësit e të gjitha revistave të fakulteteve të UP-së që dalin aktualisht, thonë se kanë 'peer review', mirëpo ato nuk i përmbushin kriteret e kërkuara për një revistë me 'peer review'.

⁷⁷ Intervistë me e-mail me Faton Tishukajn, profesor në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe i Sportit, 4 shtator 2018.

⁷⁸ Intervistë me e-mail me Florim Isufin, profesor në FShMN, 4 shtator 2018.

⁷⁹ Intervistë përmes viber me Agim Gashin, prodekan në FShMN, 12 shtator 2018.

revistë ishte e indeksuar në ‘Shoqatën Amerikane të Matematikantëve’ dhe ‘Shoqatën Evropiane të Matematikantëve (Zentralblatt)’. Botimi i revistës ishte ndërprerë më 1996 për shkak të rrethanave të krijuara politike (masat e dhunshme në UP, rrethanat e rënuara të punës në objekte private), por edhe për shkak se pas vdekjes së Profesor Eshref Ademaj mungonte vullneti për të vazhduar me botime.⁸⁰ Revista kishte ISSN si dhe ‘peer review’⁸¹. Po ashtu, Departamenti i Kimisë nxirrte revistën «Acta Chemica Kosovica» nga viti 1981 e deri më 2012. Gjithsej janë botuar 16 numra⁸². Në të janë publikuar punime me recenzent të lëmisë së kimisë, nga autorë shqiptarë dhe të huaj, në shqip dhe anglisht. Këshilli redaktues i revistës përbëhej nga Shoqata e Kimistëve të Kosovës dhe kishte donator vullnetar⁸³. Revista është ndërprerë kryesisht për shkaqe financiare.

Që nga viti 1973 FShMN-ja nxirrte edhe revistën «Buletini», e cila përmbante kryesisht punime nga profesorë vendorë dhe financohej nga UP-ja, por që nga viti 2006 është ndërprerë botimi për shkak të vështirësive financiare. Pra, duhet theksuar se nga gjitha revistat që botohen ose janë botuar nga ky fakultet, vetëm «Punime Matematike» kishte ISSN dhe peer review. Sa i përket parapagimit në revista ndërkombëtare, ky fakultet nuk parapaguhet në to. FShMN-ja ka pesë departamente (biologjia, fizika, matematika, kimia dhe gjeografia) dhe nxjerrë vetëm një revistë.

“ Nga intervistat e zhvilluara me dekanë, botues të revistave dhe profesorë, del se arsyet kryesore për ndërprerjen e revistave janë mungesa e financave, mungesa e honorareve, si dhe mos-stimulimi i profesorëve për të publikuar në to, meqë nuk u shërbejnë për avancime.

⁸⁰ Intervistë me Naim Brahën, profesor në FShMN, 3 shtator 2018.

⁸¹ Intervistë përmes viber me Agim Gashin, prodekan në FShMN, 12 shtator 2018.

⁸² Intervistë me e-mail me Agim Gashin, prodekan në FShMN, 12 shtator 2018.

⁸³ Intervistë me e-mail me Gani Jashari, profesor në FShMN, 4 shtator 2018.

Përfundime

- Në të kaluarën janë botuar 14 revista nëpër fakultete të ndryshme të UP-së dhe 3 revista të tjera janë botuar në mënyrë kryesisht vetanake nga profesorë të fakulteteve të ndryshme të UP-së.
- Aktualisht nga 13 fakultete, me gjithsejt 41 departamente, botohen vetëm 5 revista në 4 fakultete të UP-së: «Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare», «Filologjia», «Balkan Economic Review», «E Drejta» dhe «Kërkime Gjeografike». Në 9 fakultete të tjera të UP-së nuk botohet asnjë revistë.
- Prej këtyre 5 revistave, vetëm 2 - «Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare» dhe «Balkan Economic Review» - kanë ISSN (kod të pranuar e të njohur ndërkombëtarisht për publikimet serike), që është kriter teknik për revista.
- Prej këtyre 5 revistave, vetëm 2 - «Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare» dhe «Balkan Economic Review» - i kanë të gjithë numrat online e të qasshëm nga publiku, që po ashtu është kriter teknik për revista. Ndërsa 3 revista i kanë vetëm disa numra online.

- Përgjegjësit e të gjitha revistave të fakulteteve të UP-së që dalin aktualisht, thonë se kanë ‘peer review’, mirëpo ato nuk i përmbushin kriteret e kërkuara për një revistë me ‘peer review’:
 - a) asnjë prej këtyre revistave nuk gjenden në databazat serioze ku janë të indeksuara revistat me ‘peer review’, si: SCOPUS, WOS ose në ndonjë databazë tjetër serioze e fushës së ngushtë;
 - b) në asnjë prej artikujve të këtyre revistave nuk figuron emri i redaktorit që e ka përcjellur procesin e vlerësimit të artikullit;
 - c) në asnjë prej këtyre revistave nuk ka të dhëna për datën e dërgimit të punimit në revistë dhe datën e pranimit të punimit nga redaktori i revistës.
 - Nga intervistat e zhvilluara me dekanë, botues të revistave dhe profesorë, del se arsyet kryesore për ndërprerjen e revistave janë mungesa e financave, mungesa e honorareve, si dhe mos-stimulimi i profesorëve për të publikuar në to, meqë nuk u shërbejnë për avancime.
-

PËRFUNDIME

PËRFUNDIME

- Për burimet njerëzore, AKA-ja ka dhënë rekomandime ose vërejtje për 4 fakultete. Prej tyre, 2 fakultete (FNA-ja dhe Mjekësia) i kanë zbatuar rekomandimet, e 2 tjera - FIEK-u ('inxhinieria kompjuterike') dhe FShMN-ja ('matematika') - nuk i kanë zbatuar. Në drejtimin e 'inxhinierisë kompjuterike' thonë se rekomandimi për burime njerëzore nuk është zbatuar për shkak të kufizimeve buxhetore dhe mungesës së ekspertëve në nivel vendi, e në drejtimin 'matematikë', thonë ky rekomandim nuk është zbatuar, ngaqë pjesa më e madhe e stafit të këtij drejtimi janë të angazhuar në të paktën edhe një institucion tjetër të arsimit, e për rrjedhojë rrallë mund të gjenden profesorët e këtij drejtimi në fakultet. Po ashtu, për 2 fakultete AKA-ja e ka potencuar si problem serioz angazhimin e stafit akademik në institucione tjera, por deri më tani asgjë nuk është ndërmarrë për ta ndalur këtë.
- Lidhur me infrastrukturën, AKA-ja ka dhënë rekomandime ose vërejtje për 10 fakultete, e për 5 prej tyre ka konstatuar se gjendja është e rëndë. Nga intervistat me dekanë kuptuam se 3 fakultete janë në listë urgjente për ndërtim - Ekonomia, FShMN-ja dhe Sporti - por, deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim.
- Për 4 fakultete AKA-ja ka rekomanduar decentralizimin e buxhetit, duke e konsideruar gjendjen aktuale problem qëndror, por deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim. Po ashtu, për 3 fakultete (Mjekësia, Edukimi dhe Artet) AKA-ja, e madje edhe menaxhmentet e këtyre fakulteteve, kanë sugjeruar idenë e decentralizimit të tërësishtëm, por për këtë nuk është ndërmarrë asgjë.
- Rreth hulumtimeve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare AKA-ja ka dhënë rekomandime ose vërejtje për 7 fakultete: të bëhet më shumë punë hulumtuese dhe të përfshihen studentët; të punohet më shumë në bashkëpunime ndërkombëtare dhe në shkëmbime të stafit dhe të studentëve.

Dekanët thonë se është vështirë të nxiten profesorët për hulumtime meqë nuk ka mbështetje financiare për këtë.

- Sa i takon programit akademik, për 10 fakultete AKA-ja ka dhënë rekomandime ose vërejtje lidhur me: ngjashmëritë ose përsëritjet e përmbajtjeve akademike; përshkrimet e pamjaftueshme, të paqarta ose të përgjithësuara të lëndëve. Dekanët thonë se kanë krijuar grupe punuese e se këto të meta do të rregullohen deri në akreditimin e radhës.
- Për 4 fakultete AKA-ja ka dhënë vërejtje që profesorët nuk i marrin rezultatet e vlerësimeve të studentëve për profesorët. Madje, edhe dekanët e fakulteteve tjera që intervistuaam shprehën të njëjtin shqetësim, duke thënë se për këtë përgjegjësi është Rektori i UP-së.
- Për 2 fakultete dekanët theksojnë nevojën e një analize të programeve konform nevojave të tregut, por deri më tani asgjë nuk është bërë në këtë drejtim as nga fakultetet, as nga UP-ja, e madje as nga institucionet relevante shtetërore.
- Bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk janë të furnizuara me literaturë bashkëkohore: nuk ka literaturë adekuate për drejtimet specifike të fakulteteve përkatëse dhe nuk ka qasje në databaza ndërkombëtare shkencore. Madje, edhe pse UP-ja ka qasje në revistat e ELSEVIER-it, bibliotekat e fakulteteve dhe studentët nuk mund të qasen në këto revista.
- Të gjitha bibliotekat e fakulteteve të UP-së së bashku kanë afro 122 mijë ekzemplarë, e sipas të dhënave të Rektoratit, UP-ja ka gjithsejt 48.735 studentë, që i bie se bibliotekat e fakulteteve të UP-së kanë 2.5 libra për student. Për nga numri i librave për student prinë Mjekësia me 10, pastaj Filologjia me 5 dhe Filozofia e FShMN-ja me nga 3.
- Të gjitha sallat e fakulteteve të UP-së së bashku, duke përfshirë Fakultetin e Edukimit dhe të Ekonomisë, kanë afro 1.200 ulëse, e sipas të dhënave të Rektoratit, UP-ja ka gjithsejt 48.735

studentë, që i bie se sallat e fakulteteve të UP-së kanë afërsisht 1 ulëse për 50 studentë.

- Asnjë nga bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë kompjuterë, printer, skaner e as fotokopjues, madje disa prej tyre, si: Fakulteti i Filologjisë, Fakulteti i Mjeksësisë dhe Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore, nuk kanë as internet.
- Bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë resurse të mjaftueshme njerëzore, madje Fakulteti i Arteve, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Edukimit nuk kanë as bibliotekistë, e për rrjedhojë ato edhe janë të mbyllura.
- Bibliotekat e fakulteteve të UP-së i regjistrojnë librat në Excel ose në librin amë, mënyra këto të tejkaluara tashmë, që do të thotë se nuk kanë një program specifik online për regjistrimin e librave (me përjashtim të Fakultetit Juridik që e ka një program, por jo të plotë), i cili do t'ua lehtësonte punën jo veç bibliotekistëve, por edhe studentëve, duke u mundësuar të rezervojnë libra online e ta zgjasin kohën e lejuar të huazimit, e me radhë.
- Asnjë nga bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë libra online.
- Në të kaluarën janë botuar 14 revista nëpër fakultete të ndryshme të UP-së dhe 3 revista të tjera janë botuar në mënyrë kryesisht vetanake nga profesorë të fakulteteve të ndryshme të UP-së.
- Aktualisht nga 13 fakultete, me gjithsej 41 departamente, botohen vetëm 5 revista në 4 fakultete të UP-së: «Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare», «Filologjia», «Balkan Economic Review», «E Drejta» dhe «Kërkime Gjeografike». Në 9 fakultete të tjera të UP-së nuk botohet asnjë revistë.

- Prej këtyre 5 revistave, vetëm 2 - «Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare» dhe «Balkan Economic Review» - kanë ISSN (kod të pranuar e të njohur ndërkombëtarisht për publikimet serike), që është kriter teknik për revista.
- Prej këtyre 5 revistave, vetëm 2 - «Revista e Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare» dhe «Balkan Economic Review» - i kanë të gjithë numrat online e të qashtëm nga publiku, që po ashtu është kriter teknik për revista. Ndërsa 3 revista i kanë vetëm disa numra online.
- Përgjegjësit e të gjitha revistave të fakulteteve të UP-së që dalin aktualisht, thonë se kanë ‘peer review’, mirëpo ato nuk i përmbushin kriteret e kërkuara për një revistë me ‘peer review’:
 - a) asnjë prej këtyre revistave nuk gjenden në databazat serioze ku janë të indeksuara revistat me ‘peer review’, si: SCOPUS, WOS ose në ndonjë databazë tjetër serioze e fushës së ngushtë;
 - b) në asnjë prej artikujve të këtyre revistave nuk figuron emri i redaktorit që e ka përcjellur procesin e vlerësimit të artikullit;
 - c) në asnjë prej këtyre revistave nuk ka të dhëna për datën e dërgimit të punimit në revistë dhe datën e pranimit të punimit nga redaktori i revistës.
- Nga intervistat e zhvilluara me dekanë, botues të revistave dhe profesorë, del se arsyet kryesore për ndërprerjen e revistave janë mungesa e financave, mungesa e honorareve, si dhe mos-stimulimi i profesorëve për të publikuar në to, meqë nuk u shërbejnë për avancime.



SHTOJCË

Më 16 nëntor 2018 i dërguam një kërkesë për intervistë Rektorit dhe prorektorëve të UP-së. Në të njëjtën ditë morëm këtë përgjegje nga Rektorati:

“Rektori Dema është tejet i interesuar që të bashkëpunoj me ju në këtë drejtim, mirëpo, për shkak të agjendës së ngarkuar që ka në javët në vijim, e kemi të pamundur që të caktojmë një takim me hapësirën kohore të nevojshme për realizimin e intervistës. Për të pasur mundësi që Rektori Dema të kontribuoj në realizimin e këtij hulumtimi, ne ju lusim që ti përcillni pyetjet e juaja me anë të emailit dhe në ditët në vijim do të merrni përgjigje nga ana e Rektorit”.

Ndonëse nuk na pëlqeu ideja për intervistë përmes e-mailit, tri ditë pas, më 19 nëntor 2018, ia dërguam pyetjet Rektoratit. Pas një jave, më 26 nëntor 2018, ia dërguam edhe një letër Rektorit për t’ia përkujtuar se po i presim përgjegjet e tij. Deri më sot, 10 dhjetor 2018, kur po e nisim për shtyp këtë raport, nuk kemi marrë përgjegje. Sidoqoftë, pyetjet dërguar Rektoratit, po i publikojmë këtu:

Pyetjet për Rektorin e Universitetin e Prishtinës, prof. dr. Marjan Dema

1.

- a) Bazuar në intervistat me dekanë dhe profesorë të Fakulteteve Teknike, konkretisht në FIEK, del se ka mungesë të ekspertëve në nivel vendi, si rrjedhojë ka gjasa që të mbyllen drejtime të caktuara në vitet në vijim. A ka ndonjë plan për këtë? Si do menaxhohet kjo situatë?
- b) Kufizimet buxhetore janë një tjetër arsye pse nuk rritet numri i stafit akademik, e sipas dekanëve dhe ekspertëve të AKA-së, kjo është kryesore në rritjen e cilësisë. Ku qëndron problemi dhe si mendoni ta zgjidhni këtë?
- c) Ka ankesa nga dekanati i FShMN-së se profesorët e

departamentit të matematikës nuk janë të rregullt në ligjërata, meqë janë të angazhuar në dy e më shumë institucione tjera arsimore (problem të cilin e kemi identifikuar edhe në raportin tonë «Stafi Akademik i UP-së». A jeni të njoftuar me këtë? Si do veproni (në këtë rast dhe jo vetëm), pasi që janë të shumtë profesorët që angazhimet jashtë UP-së i konsiderojnë si dytësore, në mungesë të shqiptimit të masave?

d) Sipas ekspertëve të AKA-së angazhimi i stafit akademik në institucione tjera vazhdon të jetë problem serioz, por deri më tani asgjë nuk është ndërmarrë në këtë drejtim. Pse nuk merrën masa? Pse vazhdon të keqpërdorët statuti i UP-së? Çfarë do të bëjë rektorati për ta rregulluar këtë?

2. Për 10 fakultete të UP-së AKA-ja ka dhënë rekomandime ose vërejtje rreth infrastrukturës. Në 5 prej tyre gjendja është shumë e rëndë, e 3 prej tyre janë në listë urgjente për ndërtim - Ekonomia, FShMN-ja dhe Sporti – por, deri më tani nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim. Çfarë po bëhet në këtë drejtim? Konkretisht çka nënkupton “lista urgjente për ndërtim”? A mund të na tregoni se kur pritet fillimi i punëve?

3. Për 4 fakultete AKA-ja ka rekomanduar decentralizimin e buxhetit. Cili është qëndrimi i Rektoratit rreth decentralizimit të buxhetit? A pritet të ndodhë një gjë e tillë?

4.

a) Bazuar në intervistat e zhvilluara me dekanë e profesorë, del se arsyeja kryesore pse stafi nuk merret mjaftueshëm me hulumtime është mungesa e incentivave (nuk paguhen, nuk u hiqen shpenzimet e hulumtimit dhe nuk shërbejnë për avancime akademike). Si mendoni të nxisni më shumë punën kërkimore?

b) Çka po bëhet për krijimin e bashkëpunimeve dhe shkëmbimeve ndërkombëtare?

5. Nga hulumtimi ynë del se programet akademike të UP-së kanë probleme si: ngjashmëritë ose përsëritjet e përm-

bajtjeve akademike; përshkrimet e pamjaftueshme, të paqarta ose të përgjithësuara të lëndëve, e me radhë. Pse ndodhë kjo? Si mendoni t'i evitoni këto në të ardhmën?

6. Edhe ekspertët e AKA-së, e edhe dekanët e fakulteteve të UP-së, kanë shprehur shqetësimin se profesorët nuk i marrin rezultatet e vlerësimeve që bëhen nga studentët në fund të semestrit. Pse? Ku qëndron problemi?

7. Për tri prej fakulteteve është sugjeruar ideja e decentralizimit. Cili është qëndrimi juaj për këtë?

8. Ekspertët e AKA-së dhe dekanët e fakulteteve të UP-së theksojnë nevojën e një analize të mirëfilltë të programeve konform nevojave të tregut. Pse nuk ka një analizë të tillë?

9. Bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk janë të furnizuara me literaturë bashkëkohore: nuk ka literaturë adekuate për drejtimet specifike të fakulteteve përkatëse dhe nuk ka qasje në databaza ndërkombëtare shkencore. Pse janë kaq të varfëra bibliotekat e fakulteteve të UP-së (bibliotekat e fakulteteve të UP-së kanë 2.5 libra për student)? A keni ndonjë plan për furnizimin e bibliotekave me literaturë adekuate?

10. Pse nuk ka salla dhe ulëse të mjaftueshme për lexim/studim në fakultetet e UP-së?

11. Pse bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë kompjuterë, printer, skaner e as fotokopjues, e disa prej tyre nuk kanë as internet? A ka ndonjë plan konkret për këtë?

12. Problem serioz është fakti se bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë resurse të mjaftueshme njerëzore, madje Fakulteti i Arteve, Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Edukimit nuk kanë as bibliotekistë. Fakultetet përkatëse kanë bërë kërkesa të vazhdueshme në Rektorat për të hapë konkurs/punësuar një bibliotekiste, por deri

më tani skanë marrë përgjigje. Pse po ndodhë kjo? Pse nuk shpallet konkurs kur ka vite që në disa fakultete këto pozita janë vakante? Kur do të merren masa?

13. Bibliotekat e fakulteteve të UP-së i regjistrojnë librat në Excel ose në librin amë, mënyra këto të tejkaluara tashmë, që do të thotë se nuk kanë një program specifik online për regjistrimin e librave (me përjashtim Fakultetit Juridik që e ka një program, por jo të plotë). Gjithashtu, asnjë nga bibliotekat e fakulteteve të UP-së nuk kanë libra online. A ka në plan rektorati që të blej ose krijoj një program adekuat për bibliotekë? Nëse po, kur?

14. Të gjitha fakultetet e UP-së bashkë botojnë 5 revista. Në të kaluarën ka pasur afërsisht 14 revista nga fakultete të ndryshme të UP-së. Pse janë ndërprerë?

15. Pse këto 5 revista që botohen aktualisht nuk kanë ‘peer review’? Pse nuk shërbejnë për avancime akademike?

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

378.2(496.51)(047)

Universiteti i Prishtinës : raportet e akreditimit, bibliotekat dhe revistat / ky raport u hartua nga Shkëlzen Gashi, Aulonë Memeti. - Prishtinë : Admovere, 2018. – 84 f. : ilustr. ; 21 cm.

1. Gashi, Shkëlzen 2. Memeti, Aulonë

ISBN 978-9951-8961-3-9